



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional të
Akademisë së Forcave të Armatosura
Maj 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

- | | | |
|---|--------------------|----------|
| 1 | Znj. Mandy Hobart | Kryetare |
| 2 | Profesor Mark Hunt | Anëtar |
| 3 | Dr. Benita Stavre- | Anëtare |

Data: 25 deri 26 maj 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi.....	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Gjykimi i përmbledhur.....	6
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	12
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	17
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre.....	26
Lista e dokumenteve.....	30

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët, se si IAL-ja i përmbush Standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të që të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve). Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen më poshtë.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është një institucion publik i arsimit të lartë dhe pjesë e sistemit arsimor të Ministrisë së Mbrojtjes, që ofron dhe drejton shërbimin e saj kombëtar të arsimit të lartë. Misioni i saj është “Arsimimi dhe kualifikimi i personelit ushtarak dhe civil për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë në vend, në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes në të tre ciklet e studimit”. Akademia ofron programet e saj në partneritet me universitetet shqiptare dhe të huaja dhe me institucionet partnere të NATO-s.

Zanafilla e arsimit ushtarak në Shqipëri daton që nga krijimi i shtetit të ri shqiptar me themelimin e shkollës së parë ushtarake në vitin 1926, pasuar nga Shkolla Mbretërore Ushtarake në vitin 1928. Pas një periudhe pushtimi gjatë Luftës së Dytë Botërore, në maj të vitit 1958, u ngrit “Shkolla e Lartë Ushtarake” bazuar në një vendim të Këshillit të Ministrave, nën komandën e kolonel Thomas Xhixho. Programet e para të Akademisë përfshinin studime në shkencat sociale; megjithatë, fokusi i saj ishte në një program tre-vjeçar të arsimit profesional ushtarak.

Në shtator të vitit 1961, pas një vendimi tjetër të Këshillit të Ministrave, Shkolla e Lartë Ushtarake u quajt Akademia Ushtarake, me misionin e ofrimit të “arsimit të lartë ushtarak”. Për disa vite Akademia vazhdoi të realizonte programin trevjeçar ushtarak, së bashku me një kurs përgatitor njëvjeçar për oficerët. Në janar të vitit 1966, Akademia Ushtarake e ndryshoi përqendrimin e sa tek përgatitja e zyrtarëve për rolet e reja, duke përfshirë komandën strategjike dhe logjistike. Pas ristrukturimit të ushtrisë në vitet 1982-83, Akademia paraqiti një procedurë përzgjedhjeje për stafin, që reflektonte kërkesat për ekspertizë akademike, dhe kërkimet ushtarake dhe shkencore u bënë pjesë e misionit të Akademisë. U krijua një strukturë e veçantë për Studimet Shkencore Ushtarake, e cila ndërmori kërkime në historinë ushtarake të Shqipërisë dhe prioritetet ushtarake që po dilnin aktualisht. Shërbimi i arsimit të lartë në nivel diplome u ofrua nga Akademia që nga fundi i viteve 1970, dhe Akademia ka dhënë 147 diploma Doktorature, 119 diploma të Master të Shkencave dhe 112 diploma Master. Në Akademi kanë studiuar rreth 7,500 oficerë, të cilët më pas ia përkushtuar përmbushjes së detyrave në poste të larta brenda Forcave të Armatosura. Megjithatë, gjatë kohës së vlerësimit, programet e studimeve të diplomës ishin pezulluar si rezultat i ristrukturimit dhe vlerësimit nga Ministria e Mbrojtjes.

Raporti i përmbledhur

Akademia e Forcave të Armatosura (Akademia) është një institucion publik, kampusi i të cilit ndodhet në Tiranë, në një bazë ushtarake, që përfshin edhe Ministrinë e Mbrojtjes dhe Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit. Akademia ka një mandat për mbështetjen e studentëve për të kryer programe të ciklit të parë në universitete në Shqipëri dhe jashtë vendit, dhe deri në vitin 2014 ka ofruar programe të ciklit të dytë dhe të tretë derisa këto u pezulluan në pritje të një vlerësimi të programeve si pjesë e strategjisë së Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin afatgjatë të Forcave të Armatosura 2016-2025. Akademia ka një Fakultet të vetëm të Sigurisë dhe Mbrojtjes që përfshin Departamentin e Operacioneve, Departamentin e Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore, Departamentin e Strategjisë dhe Historisë, Qendrën e Gjuhëve të Huaja dhe Departamentin e Përgatitjes së Oficerit të Ri. Akademisë i është dhënë statusi i veçantë nga Ministria e Arsimit në mars të vitit 2017 sipas nenit 60 të Ligjit për Arsimin e Lartë. Akademia ka 88 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë me kohë të plotë, që studiojnë në universitete të tjera të larta, si dhe studentë në programet e gjuhës dhe në Kursin e Lartë të Oficerit, Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kurset e Karrierës së Kapitenëve dhe Kursin e Oficerëve. Kurset që nuk lidhen me program diplome zgjasin katër deri 10 muaj.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u përgatit nga një grup në Akademi ku përfshiheshin oficerë të lartë, staf akademik dhe personel mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve. Janë hartuar raporte të veçanta për secilën nga fushat, dhe pas vlerësimit dhe diskutimit me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, u përpiluan në një raport të vetëm të vetëvlerësimit, që u miratua nga Rektori.

Vizita u zhvillua për më shumë se një ditë e gjysmë më 25 dhe 26 maj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy vlerësues të arsimit të lartë me eksperiencë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga stafi i një universiteti shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Drejtuesi i Vlerësimit dhe një person nga Agjencia Publike e Akreditimit për Arsimin e Lartë për mbajtjen e shënimeve. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion një Raport Vetëvlerësimi dhe dosjen e dokumenteve mbështetëse tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, që u plotësua më vonë me dokumentacion shtesë të kërkuar. Në tërësi, rreth 110 dokumente e njohin Grupin e Vlerësimit të Jashtëm me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga Akademia. Dokumentet përfshinin Statutin e Akademisë, Rregulloren Akademiçe, Kodin e Etikës, raportet vjetore, marrëveshjet e bashkëpunimit, procesverbalin e mbledhjeve vendimmarrëse, Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, doracakët e studentëve dhe anketimet e studentëve dhe të stafit

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me rektorin, drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin administrativ dhe atë ndihmës gjatë vizitës së vlerësimit. Diskutimi ishte në funksion të sqarimit të procedurave, përgjegjësisë, dispozitave aktuale dhe pikëpamjeve. Shënimet u morën në të gjitha mbledhjet. Si pjesë e një vizite në kampusin kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët e gjuhës, muzeun dhe objektet sportive. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu ofrua një prezantim mbi Qendrën e Simulimit dhe i vrojtuan studentët teksa angazhoheshin në simulime.

Akademia ka procedura të qarta për menaxhimin dhe organizimin e kurseve të saj. Shërbimi i ofruar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja së bashku me gamën e marrëveshjeve të

partneritetit me universitetet dhe institucionet e NATO-s, mbështet në mënyrë të efektshme personelin ushtarak në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik dhe përbën praktikë të mirë. Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme për studentët e ciklit të tretë për të përfunduar kualifikimet e tyre të Doktoraturës, ndonëse një rezultat i vendimit të jashtëm, evidentohet si një dobësi dhe duhet të trajtohet si prioritet. Rekomandohet që Akademia të shqyrtojë mundësitë me organizatat partnere, për të lehtësuar studentët që të përfundojnë studimet, edhe pse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pranon se kjo do të kërkojë mbështetjen dhe miratimin e Ministrisë. **Standardet I.1- I.6, Standardi II.1, Standardi II.3, dhe Standardet III.1- 4 që përfshihen tek Kapitulli III**, janë përbushur kryesisht.

Përgjegjësitë për burimet përcaktohen qartë në statutin dhe rregulloret e Akademisë së Forcave të Armatosura. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikën e mira në aspektin e ambienteve akademike dhe praktike në dispozicion për të mbështetur mësimdhënien e studentëve, duke përfshirë laboratorët gjuhësorë të cilësisë së lartë dhe burimet e mësimdhënies dhe burimet e muzeut, i cili siguron materiale dhe kontekste historike, për të mbështetur strategjinë ushtarake dhe studimet e udhëheqjes. Nuk u identifikuan dobësi dhe nuk u dhanë rekomandime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon planet e vendosura për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes qendrore dhe sigurimin e daljeve emergjente në të gjitha strukturat të përbushin kërkesat e Standardeve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se **Standardi IIV.1-4, Standardi II.2, Standardet VI.1-3, Standardi VII.1-6, Standardet V.1-2 që përfshihen tek Kapitulli III** janë përbushur kryesisht.

Akademia ka procese të rregulluara në funksion të menaxhimit të shërbimit të vet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se qasja e jashtme ofruar nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra në shërbim të përmirësimit të cilësisë së menaxhimit të programit dhe përcjelljen, nëpërmjet vlerësimit të paanshëm të shërbimit, është një praktikë e mirë. Stafi akademik ka mundësi të kufizuara për t'u angazhuar në kërkim shkencor, gjë që do të mbështeste ofrimin e studimeve pasuniversitare. Këto ndikojnë tek potenciali për të orientuar zhvillimin e programeve të reja, në përbushje të ekspertizës së ardhshme ushtarake, gjë që paraqitet si dobësi. Rekomandohet që të identifikohet shërbimi i duhur i arsimit të lartë për vlefësim, bazuar në dispozitat aktuale dhe lidhjet e kurrikulës dhe të ringrihet një njësi kërkimore për të mbështetur arritjet pasuniversitare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bërë asnjë pohim në këtë fushë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se kërkesat e **Kapitullit I Standardi I.1-12** janë përbushur kryesisht.

Përgjegjësitë për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit janë të përcaktuara në statut dhe rregullore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë aspekt të praktikës së mirë. Dobësitë u identifikuan në infrastrukturën e kufizuar që ka Akademia për stafin kërkimor shkencor, që nuk ka mundësuar prioritizimin e kërkimit shkencor dhe vlerësimin e rezultateve në projektet shkencore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Akademia të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të zhvilluar një plan kërkimi shkencor, për të ndërtuar kapacitetet kërkimore të stafit, për të promovuar rezultatet e kërkimit, për të menaxhuar shpërndarjen dhe për të vlerësuar performancën e kërkimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bërë asnjë pohim. U konstatua që **Standardet II.1-4, Standardet I.1-8 tek Kapitulli I** janë përbushur kryesisht.

Akademia është e përkushtuar që t'i përbush nevojat e studentëve të saj, duke i angazhuar studentët në organet vendimmarrëse të Akademisë, duke ofruar mësim, burime

të aksesueshme, tutorim dhe mbështetje. Ai siguron si ambientet kurrikulare, ashtu edhe ekstrakurrikulare në ambientet e kampusit për studentët e saj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Akademia dhe stafi i saj kanë identifikuar nevojën për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe shërbimeve në internet të ofruara për studentët dhe stafin, që mbështeten nga një program për digjitalizimin e burimeve të bibliotekave. Nuk ka shembuj të praktikës së mirë, dobësive apo rekomandimeve për këtë fushë të vlerësimit. U konstatua që **Standardet III.1-9 tek Kapitulli I** janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- shërbimi i Qendrës ndërevepruese dhe cilësore të Gjuhëve të Huaja që mbështet personelin ushtarak për të studiuar jashtë vendit (pika 1.8; **Kapitulli III Standard II. 1**)
- gama e marrëveshjeve të partneritetit me universitetet dhe institucionet e NATO-s, mbështet në mënyrë të efektshme personelin ushtarak në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik (pika 1.12; **Kapitulli III Standard III. 2 dhe Standardi III. 3**)
- burimet e muzeut, që ofrojnë materiale historike, dhe ofrojnë kontekst për të mbështetur strategjinë ushtarake dhe studimet e udhëheqjes (pika 2.12; **Kapitulli III Standard VII. 4**)
- gama e gjerë e mjediseve akademike dhe praktike në dispozicion, për të mbështetur mësimxënien e studentëve, përfshirë laboratorët gjuhësorë me cilësi të lartë, Qendrën e Simulimit luftarak të teknologjisë së lartë dhe gamën e gjerë të burimeve mësimore (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi V. 1**)
- qasja e jashtme e ofruar nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra shërben për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit të programit dhe përcjelljen, nëpërmjet vlerësimit të paanshëm të shërbimit të ofruar (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi I. 1 dhe Kapitulli I Standardi I. 10**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e sistemeve për të mbështetur studentët e regjistruar në studimet e Doktoraturës për përfundimin e studimeve të tyre (pika 1.10, **Kapitulli III Standardi II.3**)
- mundësi të kufizuara për stafin që të angazhohet në kërkim shkencor, gjë që do të mbështeste mësimdhënien e tyre dhe monitorimin e ardhshëm të studentëve të Masterit dhe Doktoraturës (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.9**)
- Akademia nuk ofron programe të plota të arsimit të lartë dhe nuk është në gjendje të zhvillojë dhe të vlerësojë shërbimin e ofruar ose të përqendrojë aktivitetet kërkimore në zgjerimin e studimeve pasuniversitare (pika 3.13; **Kapitulli I Standardi I.8 dhe Standardi I.9**)
- infrastruktura e kufizuar e Akademisë për personelin kërkimor shkencor, që nuk ka qenë në gjendje t'i japë përparësi kërkimit shkencor dhe të vlerësojë rezultatet në projektet shkencore (pika 4.10; **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Akademia të shqyrtojë mundësitë për të lehtësuar studentët e Doktoraturës që të përfundojnë studimet e ciklit të tretë (Prioritet i lartë) (pika 1.10; **Kapitulli III Standard II.3**)
- Akademia të synojë të ringrejë një njësi kërkimore për të mbështetur zhvillimin dhe ofrimin e arsimit të lartë (Prioritet i lartë) (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.9**)

- Akademia të identifikojë shërbimin e duhur të arsimit të lartë për ofrimin e tij bazuar në validimin e kurseve aktuale lidhur me praktikën për programet e studimeve me diplomë ose certifikatë (prioritet i lartë) (pika 3.13; **Kapitulli I Standard I.9**)
- Akademia të zhvillojë një plan kërkimor shkencor, që ngre kapacitetin e stafit të kërkimit shkencor, promovon rezultatet e kërkimit, menaxhon shpërndarjen dhe vlerëson performancën e kërkimit shkencor (Prioritet i lartë) (pika 4.10, **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme tashmë në proces:

- planet e përcaktuar për të përmirësuar dy daljet e emergjencës dhe sistemin e ngrohjes (pika 2.14; **Kapitulli III Standardi V.1**)
- nevoja për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe shërbimeve në internet të ofruara për studentët dhe stafin, që mbështeten nga një program për ruajtjen digjitale të burimeve (pika 5.6, **Kapitulli I Standardi III.5**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykimi i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Akademinë e Forcave të Armatosura, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Akademia e Forcave të Armatosura është një institucion publik i cili ofron programe në mbështetje të zhvillimit profesional të personelit ushtarak dhe civilëve që punojnë në shërbimet ushtarake. **[2; 5; 6; M2]** Akademia i përgjigjet Ministrisë së Mbrojtjes që jep buxhetin e saj, emëron stafin e lartë dhe miraton numrat e studentëve dhe kriteret e pranimit. Akademia njihet edhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[5; 6; 2]** Statuti dhe rregulloret aktualisht janë miratuar nga Senati Akademik respektivisht në dhjetor të vitit 2016 dhe mars të vitit 2017, dhe pasqyrojnë parimet e nenit 132 të ligjit për arsimin e lartë. Të gjitha programet, miratimi i kurrikulave dhe ofrimi i programit menaxhohen në përputhje me rregulloret. **[5; 6; M2]** AFA u pranua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në mars të vitit 2017 si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë sipas nenit 60 të ligjit për arsimin e lartë. **[M2; M3] [Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Organizimi dhe struktura e Akademisë përcaktohet qartë në statutin dhe rregulloret. **[5; 6; 7; 17]** Senati akademik është organi i lartë kolegjal brenda Akademisë dhe kryesohet nga Rektori, i cili, sipas kushteve të Statutit, duhet të jetë një zyrtar i lartë ushtarak i emëruar nga Ministria e Mbrojtjes. **[5; 18; 73]** Rektori emërohet për një periudhë katërvjeçare, e cila mund të zgjatet vetëm për katër vjet të tjera. **[5; 6]** Senati udhëhiqet nga Rektori, me anëtarë të tjerë të zgjedhur nga stafi akademik gjithashtu për një periudhë katër vjeçare. Të gjithë anëtarëve të Senatit u kërkohet të kenë gradën më të lartë akademike dhe tituj akademikë, siç janë Profesor ose Doktor, dhe duhet të kenë diplomë pasuniversitare nga një universitet evropian ose nga një vend anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. **[M2; 8]** Titullari i Fakultetit /Dekani emërohet gjithashtu nga Ministria e Mbrojtjes dhe mbikëqyr punën e Departamentit të Operacioneve, Departamentit të Liderimit dhe Shkencave Sociale, Departamentit të Strategjisë dhe Historisë, Qendrës së Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Përgatitjes së Oficerit të Ri. **[2; 5; 6] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.3 Si institucion publik, Akademia financohet nga shteti dhe merr buxhetin e saj nga Ministria e Mbrojtjes dhe ka procedura të qarta për menaxhimin e buxhetit të saj. **[5]** Administratori, i cili emërohet nga Bordi i Administrimit dhe miratohet nga Ministria e Mbrojtjes, është përgjegjës për hartimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme bazuar në informacionet e ofruara nga Fakulteti dhe Departamenti i tij, si dhe nga departamentet administrative. **[28; 78; M3; M5; M6]** Buxhetet shqyrtohen nga Senati dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, si organi i lartë administrativ, përpara se të dorëzohen në Ministrinë e Mbrojtjes për miratim përfundimtar. **[5; 6; 7]** Politikat dhe buxhetet financiare gjithashtu janë miratuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe pasqyrojnë planifikimin strategjik më të gjerë dhe zhvillimin e arsimit brenda sektorit ushtarak. **[M2; 79; 72] [Kapitulli III Standard I.2]**

1.4 Akademia ka një strukturë të qartë menaxhimi për të mbështetur zhvillimin e strategjive dhe politikave brenda kompetencave të saj dhe kufijve të autoritetit. Rektori mbështetet nga Rektorati, i cili përbëhet nga anëtarë të lartë të stafit, duke përfshirë Zëvendësrektorin, Administratorin, Drejtorin e Qendrës për Gjuhë të Huaja dhe Përgjegjësit e Departamenteve. **[5 Nene 27; 2; 6; 67]** Rektorati, i kryesuar nga Rektori, është përgjegjës për zhvillimin e Planit Strategjik bazuar në propozimet e Përgjegjësve të Departamentit, të cilët nga ana e tyre shqyrtojnë propozimet nga komisionet e departamenteve. Dekanati përbëhet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe është organi përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e mësimnxënies dhe të mësimdhënies. **[5 nenet 14-15; 67; M3]** Rektorati është përgjegjës për paraqitjen e Planit Strategjik në Senatin Akademik për miratim. Nxitet debati konstruktiv midis stafit në të gjitha nivelet dhe procesverbalet e mbledhjeve u vihen në dispozicion anëtarëve të komisioneve. **[67; 71; 5; 6]** Dokumentet që lidhen me vendimet gjithashtu u vihen në dispozicion anëtarëve të komisionit, stafit akademik dhe personelit

mbështetës, si dhe studentëve, sipas rastit. **[30; M5; M6; 5]** Strategjia e përgjithshme e zhvillimit përputhet me Strategjinë e Qeverisë për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe me strategjinë afatgjatë të zhvillimit të Ministrisë së Mbrojtjes 2015-2025. **[72; 5; M2]** **[Kapitulli III Standardi I.3]**

1.5 Akademia vazhdon të vlerësojë dhe përditësojë shërbimin e saj në përgjigje të kërkesave afatshkurtra. Përgatitja e materialeve dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Qendrës së Gjuhëve të Huaja është përqendruar në përmbushjen e nevojave më të gjera të studimit dhe mundësive mbështetëse për personelin ushtarak për të studiuar jashtë vendit, një përgjegjësi kyçe, sidomos në kushtet e pezullimit aktual të programeve të studimit me diplomë në Akademi. **[21; 20]** Është shfrytëzuar gjithashtu feedback-un nga studentët dhe stafi, për të mbështetur përmirësimet në kurrikul. **[66; M4; 50]** **[Kapitulli III Standardi I.3 dhe Standardi I.5]**

1.6 Akademia ka procese të efektshme për të siguruar menaxhimin etik të shërbimit që ofrohet. Është themeluar një Këshilli i Etikës dhe përbëhet nga pesë anëtarë të stafit të zgjedhur nga Senati Akademik, përzgjedhur nga përfaqësuesit e departamenteve, dhe një përfaqësues i studentëve. Këshilli i Etikës është përgjegjës për sigurimin e përputshmërisë me Kodin e Etikës dhe mund të hetojë problemet dhe të kërkojë informacion nga stafi akademik dhe personeli mbështetës lidhur me pajtueshmërinë ose shkeljet e praktikës etike. **[6; 9]** Kodi është miratuar nga Senati Akademik dhe është në përputhje me rregulloret ligjore, përfshirë ligjin nr. 80/2015, datë 21.09.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". **[9; M3; M2]** Duke qenë se studentët në programet e studimeve me diplomë në fund po i kryejnë aktualisht këto studime jashtë vendit, përfshirë SHBA-në, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Turqinë dhe Italinë, puna për momentin është kufizuar në mbështetjen e zhvillimit të gjuhës së studentëve, monitorimin e punës në kurset e zhvillimit profesional dhe shqyrtimin e disertacioneve të studentëve, të cilat i paraqiten Akademisë **[2; 9; M3; M5; 67.4]** për më tepër, Akademia aktualisht nuk ka Këshill të Profesorëve, që kur u pezulluan programet e ciklit të dytë dhe të tretë. **[19; 16; 73]** **[Kapitulli III Standardi I.2, Standardi I.4 dhe Standardi II.1]**

1.7 Akademia përgatit një raport vjetor që lejon reflektimin dhe vlerësimin e shërbimit të tij. Raporti është i mbështetët te feedback-u nga stafi dhe studentë, arrijtjet dhe ecuria kundrejt prioriteteve institucionale, dhe i shpërndahe të gjithë stafit. **[73; 44; 63; M3]** Raporti vjetor shqyrtohet nga Senati Akademik para se të dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mbrojtjes. **[21; 5; 6]** Informacioni për stafin akademik, ngarkesat mësimore, regjistrat e studentëve dhe informacioni gjithashtu i vihen në dispozicion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, siç kërkohet, për të provuar që praktikat e Akademisë plotësojnë kërkesat rregullatore. **[2; 18]** **[Kapitulli III Standardi I.6]**

1.8 Informacioni rreth programeve të ofruara nga Akademia vihet në dispozicion në faqen e internetit të AFA. **[Faqja e internetit]** Informacioni publik menaxhohet në përputhje me Procedurën e Informimit Publik të Akademisë **[13]** dhe bëhet i disponueshëm nëpërmjet publikimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, gazetës së Ushtrisë dhe Revistës Ushtarake. Publikohen gjithashtu katalogët e kurseve dhe programet e studimeve. **[23; Revista Ushtarake]** Meqenëse institucioni momentalisht e ka pezulluar ofrimin e programeve të studimit, ai ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë brenda Shqipërisë dhe më gjerë, gjë që lehtëson studentët për të pasur akses në programe studimi. **[19; 16; 101; 38; M3; M5]** Akademia luan një rol kyç në përgatitjen e studentëve për të studiuar jashtë vendit, qoftë në universitet ose nëpërmjet pjesëmarrjes në një nga akademitë e NATO-s, nëpërmjet punës së Qendrës së Gjuhëve të Huaja, e cila ka burime të mira. Kurset e gjuhës ofrohen në një standard të lartë që mbulon të katër elementët e përvetësimit të gjuhës dhe rezultatet e provimit njihen ndërkombëtarisht. **[20; 55; 109; M4]** Kohëzgjatja e kurseve, të cilat menaxhohen së bashku me kurset e tjera të

oficerëve, u mundëson studentëve të arrijnë nivele të mira të rrjedhshmërisë dhe të kuptojnë zakonet dhe kulturën e vendit, në të cilin planifikojnë të studiojnë. **[109; M4]** Cilësia e lartë dhe ofrimi ndërveprues i qendrave të gjuhëve të huaja, mbështet dhe ndihmon personelin ushtarak për të hyrë në programet e studimit jashtë shtetit, dhe kjo përbën praktikë të mirë **[Kapitulli III Standardi II.1]**

1.9 Akademia nuk ka një departament të sigurimit të cilësisë, dhe praktikisht, vlerësimi i programeve të trajnimit ushtarak, që mbështesin zhvillimin e karrierës së oficerëve, kryhet nga departamentet të veçanta. Mbikëqyrja realizohet nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra në Komandën e Stërvitjes dhe Doktrinës së Ministrisë së Mbrojtjes, e cila mban një pasqyrë të veçantë dhe mbështet në mënyrë të efektshme vlerësimin e arsimimit ushtarak dhe ndërtimin e praktikave të zgjeruara në bazë të rezultateve të stërvitjes. Kjo diskutohet më tej tek pika 3.8. **[6; 5; 42] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.10 Ecuria e studentëve monitorohet nga stafi i lartë akademik që diskuton për performancën individuale të studentëve dhe merr parasysh reagimet nga studentët për çështjet që kanë të bëjnë me studimet. **[M5; M4; 85; 80]** Departamenti i Kurseve mbledh informacione për mësimdhënien e studentëve dhe çështjet administrative dhe i bën informacionet të disponueshme për studentët sipas nevojës. **[7; 63]** Megjithatë, për shkak të pezullimit të programeve të ciklit të tretë, Akademia nuk ka mundur të përgatisë sisteme për t'iu mundësuar studentëve të Doktoraturës të përfundojnë studimet e tyre. Të dhënat tregojnë se 73 studentë që kanë filluar studimet e tyre në periudhën ndërmjet viteve 2010 dhe 2014 ende nuk kanë përfunduar studimet e tyre të Doktoraturës. **[104; M3; M5]** Ndërsa kjo nuk është nën kontrollin e Akademisë, mungesa e sistemeve për të mbështetur studentët e Doktoraturës që të përfundojnë studimet e tyre, përbën një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** si një prioritet të lartë që Akademia të shqyrtojë mundësitë për të lehtësuar studentët e regjistruar të Doktoraturës që të përfundojnë studimet e ciklit të tretë përpara se të ndryshohet kuadri i kërkimit të tyre. **[Kapitulli III Standardi II.3]**

1.11 Akademia kërkon, nga njësitë e Forcave të Armatosura, informacion rreth punësimit dhe zhvillimit të karrierës për studentët që kanë përfunduar studimet dhe informacioni ndihmon për të informuar zhvillimet e mëtejshme të programit. Kuotat për pranim në programet e studimit miratohen nga Shtabi i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes bazuar në analizën e kërkesave të Forcave të Armatosura dhe zbatohen kriteret konkurruese të pranimit. **[22; 6; M3]** Të gjithë studentët që përfundojnë programet e studimit punësohen nga Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes. **[Kapitulli III Standardi III.1]**

1.12 Një kornizë dhe strategji bashkëpunimi me akademitë në vende të tjera, si: Kosova, Turqia, Italia dhe Greqia mbështet personelin ushtarak për të studiuar jashtë vendit; 38 vetë nga personeli akademik kanë studiuar jashtë vendit. Partneritetet bazohen në strategjinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe prioritetet e bashkëpunimit, gjë që gjithashtu lejon bashkëpunimin me institucionet, duke përfshirë Konsorciumin e Akademive të Mbrojtjes, Qendrën Marshall, Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s dhe Qendrën e Lartë për Studimet e Mbrojtjes në Itali. **[16; M3; M4]** Përveç kësaj, Akademia ka marrëveshje me universitetet në Shqipëri, për të mbështetur zhvillimin e studimeve të ciklit të parë. **[14; 16; 75]** Puna e Akademisë me akademi të tjera ushtarake përfshin aktivitete të përbashkëta kërkimore dhe kërkime shkencore në përputhje me politikën e saj për integrimin e kërkuesve të huaj dhe stafit akademik në aktivitetet e tij. **[14; M2]** Këto rregullime plotësojnë punën e ndërmarrë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe sigurojnë që kërkimet shkencore dhe strukturimi i shërbimit të ofruar të plotësojnë kërkesat e Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Gama e marrëveshjeve të partneritetit me universitetet dhe institucionet e NATO-s, mbështet në mënyrë të efektshme personelin ushtarak në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik dhe është një karakteristikë e praktikës së mirë. **[Kapitulli III Standardi III. 2 dhe Standardi III. 3]**

1.13 Puna me akademitë e NATO-s u lejon studentëve të huaj të fillojnë studime pranë Akademisë. Studentët nga disa vende, përfshirë Kosovën, Malin e Zi, Gjeorgjinë, Italinë, Greqinë dhe Maqedoninë kanë mundësi të studiojnë pranë Akademisë, veçanërisht në Kursin e Lartë për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku 60 për qind e studentëve janë rekrutuar nga jashtë Shqipërisë. **[107; 49; 2; M3]** Akademia ka një politikë për të mirëpritur gjithashtu personelin e huaj kërkimor dhe mësimor dhe e nxit stafin e saj të ndërmarrë shkëmbime mësimore. **[2; 5] [Kapitulli III Standardi III. 4]**

1.14 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron se Akademia i përmbush kryesisht Standardet e cilësisë për Organizimin dhe Menaxhimin e tij institucional. Shërbimi i ofruar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja, së bashku me gamën e marrëveshjeve të partneritetit me universitetet dhe institucionet e NATO-s, mbështet në mënyrë të efektshme personelin ushtarak në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik dhe përbën një praktikë të mirë. Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme për studentët e ciklit të tretë që të përfundojnë studimet e tyre të doktoratës, ndonëse rezultat i vlerësimit të jashtëm, përbën një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Akademisë të shqyrtojë mundësitë me organizatat partnere, për të mbështetur studentët që të përfundojnë studimet e tyre, edhe pse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pranon se kjo do të kërkojë mbështetjen dhe miratimin e Ministrisë.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- shërbimi i Qendrës ndërvepruese dhe cilësore të Gjuhëve të Huaja që mbështet personelin ushtarak që të studiojnë jashtë vendit (pika 1.8; **Kapitulli III Standard II.1**)
- gama e marrëveshjeve të partneritetit me universitetet dhe institucionet e NATO-s, mbështet në mënyrë të efektshme personelin ushtarak në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik (pika 1.12; **Kapitulli III Standard III.2 dhe Standardi III.3**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e sistemeve për të mbështetur studentët e regjistruar në programet e Doktoraturës, për përfundimin e studimeve (pika 1.10, **Kapitulli III Standard II.3**)

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Akademia të shqyrtojë mundësitë për të mbështetur studentët e Doktoraturës që të përfundojnë studimet e ciklit të tretë (Prioritet i lartë) (pika 1.10; **Kapitulli III Standard II.3**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 AFA menaxhon rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në Statut dhe Rregullore, të cilat sqarojnë përgjegjësitë. **[36; 5; 6; 3 fq.14; 27]** Të gjitha vendet e lira shpallen dhe publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe mbështeten nga përshkrimet e vendeve të punës dhe kriteret për emërimet. **[3 fq. 14; Ligji nr. 80 / 2015- datë 21-05-07; Ref. 2h – Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes]** Promovimi i stafit bazohet në pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe reflektimin e punës së ndërmarrë në bashkëpunim me institucionet brenda rajonit, duke përfshirë edhe vendet anëtare të NATO-s. **[3 fq.14]** Akademia është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë që zhvillon arsim dhe kërkim në fushën e “sigurisë dhe mbrojtjes”. Rekrutimi i stafit akademik bazohet në personelin që ka përfunduar studimet dhe kualifikimet në akademi, kolegje dhe universitete të vendeve të NATO-s. **[3 fq. 14]** Aktualisht Akademia nuk i plotëson 70 për qind të kuotës së stafit akademik me gradë shkencore dhe tituj të përcaktuar në ligjin e arsimit të lartë, por i plotëson kushtet e nenit 17, pika 7 i këtij ligji. **[6 neni 25 pika 4; Përjashtime të veçanta të ligjit; M6; 18; 26] [Kapitulli III Standardi IV. 1]**

2.2 Kualifikimet arsimore dhe kërkesat e pranimit për stafin ushtarak që të hyjnë në shërbim, bazohen në politikat dhe detyrimet institucionale të përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes. Është planifikuar një ditë informimi për stafin e ri që punon, si në departamentet akademike, ashtu edhe ato administrative dhe ofrohen fletëpalosjet që paraqesin informacionin kryesor. Akademia ofron aktivitete sociale dhe kulturore, duke përfshirë aktivitetet promovuese, ceremonitë e daljes në pension dhe ceremonitë e dhënies së diplomave, për të forcuar marrëdhëniet dhe për të krijuar një atmosferë pozitive për stafin brenda Akademisë. Qendra kulturore ushtarake ofron kurse falas për fëmijët e stafit në sport, pikturë dhe muzikë. Sigurimi i jetës garantohehet për të gjithë personelin ushtarak dhe gjithashtu për ata që marrin pjesë në misione paqeruajtëse jashtë vendit. **[3 fq.14; 77] [ESG 1.5 Stafi mësimdhënës, Kapitulli III Standardi IV. 2]**

2.3 Trajnimi dhe kualifikimi i stafit akademik menaxhohet në bazë të matricës vjetore për secilin pjesëtar të stafit. **[Ref. 34 i RVV]** Vlerësimi mujor dhe vjetor i arritjeve të stafit bëhet nga menaxherët e linjës dhe rezultatet dhe përfundimet vendosen në dosjet personale të çdo pjesëtari të personelit akademik. Rregulloret në fuqi përcaktojnë përgjegjësitë e stafit sipas roleve të punës. **[Ref. 2.j i RVV; 3 f. 15; M6]** Akademia zbaton rregulla të qarta në përputhje me legjislacionin shtetëror **[Ligji nr. 80/2015]** për caktimin e përgjegjësive në funksionet përkatëse të punës. Përshkrimi i punës për secilin pozicion miratohet nga Rektori. **[74; 3 fq. 15] [Kapitulli III Standardi II. 2]**

2.4 Akademia zbaton planet e trajnimit për stafin akademik **[3 fq. 15 - Ref - Plani vjetor i arsimit/trajnimit të personelit]** bazuar në prioritetet e përcaktuara në projektet zhvillimore me të cilat ata angazhohen. **[3 fq. 15]** Personeli mësimdhënës ushtarak dhe civil trajnohet dhe i caktohen detyra në përputhje me marrëveshjet dhe planet e bashkëpunimit të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me vendet anëtare të Aleancës dhe akademitë Perëndimore. **[27 – Ref. 2b]** Akademia vepron në përputhje me politikat dhe standardet e miratuara nga Ministria e Mbrojtjes, në kuadër të së cilës stafi i nënshtrohet vlerësimit mujor dhe vjetor të arritjeve. Personelit i Departamentit mban një dosje elektronike dhe në format të shtypur. Për sa i përket promovimit të stafit për të marrë tituj akademikë,

Akademia iu drejtohet përfaqësuesve të institucioneve të tjera arsimore dhe kërkimore në vend, si dhe, për shembull, Kolegjit të NATO-s në Romë dhe Qendrës Marshall në Gjermani. **[3 f.15; 82] [Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.5 Ka procedura të efektshme për të mbështetur integrimin social dhe zhvillimin e stafit dhe studentëve në Akademi. Personelit i Departamentit organizon aktivitete sociale dhe kulturore në të cilat mund të marrë pjesë kushdo. Këto përfshijnë ekskursione, ture në vendet historike, aktivitete kulturore, artistike dhe sportive dhe veprimtari të tjera lidhur me arsimin e lartë, të cilat mund të jenë me interes për personelin e brendshëm ose ata që punojnë në Forcat e Armatosura. Akademia gjithashtu ofron një gamë ambientesh me cilësi të lartë, që stafi dhe studentët kanë akses, të cilat përfshijnë salla sportive të specializuara dhe fusha sportive, ku zhvillohen një sërë sportesh. **[32; 109; Vizita në terren]** Përveç kësaj, mbahen takime për të publikuar politikat dhe programet e saj me grupe të ndryshme shoqërore, duke përfshirë prezantime për shtypin dhe komunitetin vendor. **[3 fq.15; 77; M5] [Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.6 Akademia ka procedura të qarta të menaxhimit financiar. Si pjesë e programit të Edukimit Ushtarak, Akademitë financohen nga buxheti i shtetit. Megjithatë, rregulloret statutoare i mundësojnë Akademisë të gjenerojë të ardhura shtesë, nëpërmjet tërheqjes së personelit ushtarak joshqiptar në shërbimin që ofron. **[M2; 81; Faqja e internetit; 28]** Shpërndarja e burimeve financiare bazohet në strukturën e buxhetit të shtetit dhe në rregullimet e menaxhimit financiar publik. **[28; 5; 6]** Planifikimi i buxhetit mbulon një periudhë pesëvjeçare dhe përfshin plane afatshkurtra dhe afatgjata. Udhëzime ofrohen nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes, si dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. **[3 fq.16]** Buxheti i miratuar përbëhet nga fondet për “pagën”, “sigurimet shoqërore dhe shëndetësor”, “mallrat dhe shërbimet” dhe “investimet”. Buxheti për “mallra dhe shërbime” përfshin shpenzimet e zyrës, stërvitjes, ushqimit, librat dhe botimet, koordinimit, ruajtjes, shpenzimet e udhëtimit (brenda dhe jashtë vendit), bashkëpunimin civil-ushtarak dhe honoraret. **[28; 79; M2; M5; M2; M5] [Kapitulli III Standard VI.2]**

2.7 Bordi i Administrimit si organi më i lartë administrativ kolegjal është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe administrativ të Akademisë. Kjo përfshin strukturën e menaxhimit financiar, zbatimin e politikave financiare dhe rregullat e kontabilitetit. Për të siguruar transparencën buxhetore, buxhetet janë diskutuar në nivel departamenti dhe në nivel qendror. **[5; 6; M3]** Seksioni i financave është përgjegjës për rregullat e kontabilitetit dhe treguesit për monitorimin e zbatimit të politikave financiare. Buxheti kontrollohet dhe auditohet nga Ministria e Mbrojtjes. **[3 fq.16-17; 67.6; M3; M6]** Për shkak të një sërë marrëveshjesh dypalëshe, një pjesë e madhe e buxhetit caktohet për shpenzimet e udhëtimit (në vend dhe jashtë vendit), për të mbështetur studentët që udhëtojnë në vende të tjera, për studime afatshkurtra dhe afatgjata. **[16; 19; M3]** Buxheti afatshkurtër diskutohet fillimisht në nivel të çdo departamenti, duke përfshirë Departamentin e Operacioneve, Departamentin e Liderit dhe Shkencave Sociale, Departamentin e Strategjisë dhe Historisë, Qendrën e Gjuhëve të Huaja, Departamentin e Përgatitjes së Oficerit të Ri, Rektoratit dhe Njësinë e Mbështetjes së Administratës, me qëllim identifikimin e kërkesave dhe prioriteteve. **[2; 6; M3; 78]** Buxheti i përgjithshëm më pas diskutohet nga Senati Akademik dhe i dërgohet Ministrisë së Mbrojtjes për miratim. Alokimi dhe monitorimi i buxheteve kryhet nga Bordi i Administrimit, në përputhje me rregulloret e miratuara dhe dokumentacionin përkatës. Sapo të miratohen buxhetet, departamentet janë përgjegjëse për

monitorimin dhe zbatimin e tyre. [6; 5; 28; 3 fq.16; M2; M5] [Kapitulli III Standard VI.1; Kapitulli III Standardi VI.2]

2.8 Akademia i nënshtrohet kontrolleve, inspektimeve dhe auditimeve financiare si dhe auditimit të brendshëm nga Ministria e Mbrojtjes, e cila siguron në mënyrë të efektshme përputhjen me kërkesat ligjore. Ajo bën publike rezultatet e të gjitha auditimeve financiare dhe një raport i veprimtarisë financiar paraqitet në një takim të hapur për stafin dhe studentët. Raportet e auditimit shqyrtohen nga seksionet e administratës, për ta trajtuar dhe për të bërë përmirësime në ndonjë dobësi identifikuar nga kontrolli. [79; 28; 3 fq.17; M3] [Kapitulli III Standardi VI.3]

2.9 Sistemet e informacionit në Akademi i nënshtrohen legjisllacionit të Ministrisë së Mbrojtjes, për shembull “Për të drejtat e informimit” (Ligji nr. 9887) dhe “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Ligji nr. 883). Vendosen kufizime në lidhje me dokumentet e klasifikuara dhe informacione të tjera të klasifikuara në lidhje me planet dhe personelin. Jepet informacion strategjik tek niveli i Ministrisë së Mbrojtjes. [56; M1; M6; 6; ESG 1.8 Informacion Publik] [Kapitulli III Standardi VII.1]

2.10 Kërkesat për teknologjinë informative janë të përshtatshme për nevojat e stafit dhe studentëve. Akademia ka një rrjet lokal kompjuterik (LAN), siguron pajisje kompjuterike (123 PC), laboratorë kompjuteri, printera, skanera, servera dhe një sërë programesh dhe aplikacionesh të bazës së të dhënave. Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja janë në dispozicion laboratorët për stafin dhe studentët në funksion të mësimit të gjuhëve të huaja. Studentët kanë akses në një gamë jashtëzakonisht të sofistikuar të ambienteve të simulimit të teknologjisë së lartë (Qendra e Simulimit), auditorëve, sallave kompjuterike dhe dy bibliotekave. Mësimi në distancë është një objektivi i ardhshëm. [30; 29; M4; 102; M6; 2; 109; ESG 1.6 Burimet e Mësimnxënies dhe Mbështetja e Studentëve] [Kapitulli III Standard VII.2]

2.11 Akademia ka një masterplan të qartë për menaxhimin e pasurisë së saj të patundshme, për të garantuar si renovimin e ambienteve, ashtu edhe sigurinë në përputhje me planet e Ministrisë së Mbrojtjes. Administratorët e Akademisë menaxhojnë në baza vjetore inventarët e aseteve. Stafi i lartë i Akademisë mbikëqyr projektet e ndërtimit dhe rindërtimit në bashkëpunim me Komandën e Stërvitjes dhe Doktrinës, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes. [32; 35; 105; M6] [Kapitulli III Standardi VII.3]

2.12 Akademia ka dy biblioteka të cilat ruajnë dhe menaxhojnë të gjithë punën e studentëve dhe burimet më gjerë, përfshirë disertacionet, revistat shkencore dhe gazetat. Arkivat e Forcave të Armatosura dhe Muzeu i Forcave të Armatosura janë gjithashtu të aksesueshme për stafin dhe studentët. [108] Të dy bibliotekat janë të një cilësie të mirë, si në aspektin e sigurimit të librave (8,630 tituj dhe 41,543 kopje), ashtu edhe në drejtim të hapësirave të qeta të punës dhe studimit. [2; 108; 209] Akademia ka themeluar një Komision vlerësimi për të menaxhuar të gjitha donacionet dhe blerjet dhe administron kërkesat e lexuesve dhe studiuesve të bibliotekave. Literatura dhe veprat shkencore ruhen, trajtohen dhe përpunohen sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 8576 “Për bibliotekat e Republikës së Shqipërisë”. [67; 3 fq.18; M6; Vizita në terren; 54] Përveç kësaj, Muzeu i Forcave të Armatosura ofron një strukturë të shkëlqyer dhe të veçantë në

sigurimin e një konteksti historik të dobishëm dhe të përshtatshëm për punën e studentëve dhe studimet e tyre të udhëheqjes. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideroi burimet e muzeut, të cilat ofrojnë materiale dhe sfondin historik në mbështetje të strategjisë ushtarake dhe studimeve të lidhshme, si një aspekt i **praktikës së mirë**. [3 fq.18; 108; M4] **[Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.13 Infrastruktura e Akademisë është e mjaftueshme për të kryer aktivitetet e saj dhe për të mbështetur planin afatgjatë të zhvillimit të institucionit. Ambientet e Akademisë për stafin akademik është në përputhje me cilësinë dhe standardet e arsimit të lartë. [17; 36; 5] Vizita e ndërmarrë nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në burimet e institucionit, do të tregonte se burimet fizike në dispozicion ishin të një standardi të mirë. [2; 108; 109; vizita në terren; M4; M5] **[Kapitulli III Standardi VII.5]** Ndërmerren anketime periodike me studentë, përfshirë studentë shqiptarë dhe të huaj, për të vlerësuar ambientet në mënyrë që të përmirësojnë shërbimet e ofruara. [42; 44; 66; M4] Akademia gjithashtu ka akses në një gamë të burimeve të trajnimit, duke përfshirë: poligonet e zjarrit, zonat e trajnimit të Forcave Speciale, kullat e parashutës dhe poligonet e trajnimit në Biza, Feken dhe Bunavi. Gama e gjerë e ambienteve akademike dhe praktike në mbështetje të të nxënies të studentëve, përfshirë laboratorët cilësorë të gjuhës, Qendrën e Simulimit të luftës me teknologji të lartë, dhe gamën e gjerë të burimeve të mësimdhënies konsiderohen si një aspekt i **praktikës së mirë**. [32; 10; 72; M2; M4] **[Kapitulli III Standard VII.6]**

2.14 Ambientet e mësimdhënies kanë akustikë të mirë, dritë natyrore, mbrohen nga lagështia dhe luhatjet e temperaturës, dhe ndodhen larg zonave industriale dhe të ndotura. Pasuritë plotësojnë normat e hapësirës së përdorshme, për shembull, 3.8 - 4.0 m²/student minimal dhe 7.5 - 8.0 m²/student maksimumi. Është vendosur një sistem i mbrojtjes nga zjarri dhe një sistem kundër shkarkimeve atmosferike. Akademia ka burime alternative të furnizimit me energji elektrike dhe siguron rezerva të ujit, dhe ofron hapësirë për trajnimin praktik të studentëve në programet e mbrojtjes dhe sigurisë. Stërkitja praktike përfshin edhe vizitat, betejat, operacionet brenda dhe jashtë vendit me vendet anëtare të NATO-s. Sidoqoftë, disa dalje nga ndërtesat nuk kanë shkallë emergjente dhe sistemi i ngrohjes mbulon vetëm pjesërisht kampusin. Daljet e emergjencës dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes janë planifikuar të përfundojnë, si pjesë e planit afatmesëm të zhvillimit të Akademisë ndërmjet viteve 2018 dhe 2020. [105; 72] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se planet aktuale, për të përmirësuar dy daljet e emergjencës dhe sistemin e ngrohjes duhet të përfundojnë jo më vonë se viti 2020. [3 fq.19; 105; 32] **[Kapitulli III Standardi V.1]**

2.15 Sekretaritë mësimore janë përgjegjëse për ruajtjen e dokumenteve në format të shtypur. Dokumentacioni administrohet nga sekretaria mësimore, që është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrimit elektronik të studentëve dhe të dhënave kurrikulare. Akademia ka një regjistër bazë të studentëve në format të shtypur dhe elektronik. Notat e studentëve ruhen në një bazë të dhënash. [3 fq.19; 31; M6] **[ESG 1.7 Menaxhimi i Informacionit; Kapitulli III Standardi V.2]**

2.16 Përgjegjësitë për burimet janë të përcaktuara qartë në statutin dhe rregulloret e Akademisë së Forcave të Armatosura. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktika të mira në gamën e ambienteve akademike dhe praktike në dispozicion, për të mbështetur të nxënies të studentëve, duke përfshirë laboratorët cilësorë të gjuhës dhe burimet e mësimdhënies dhe burimet e muzeut që ofron materiale historike dhe sfondin për të

mbështetur strategjinë ushtarake dhe studimet e udhëheqjes. Nuk u identifikuan dobësi dhe nuk u dhanë rekomandime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon planet aktuale për të përmirësuar sistemet e ngrohjes qendrore dhe për të siguruar që daljet e emergjencës në të gjitha fushat të plotësojnë kërkesat e standardeve.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristika e mëposhtme të praktikës së mirë:

- burimet e muzeut të cilat ofrojnë materiale historike dhe sfondin, për të mbështetur strategjinë ushtarake dhe studimet e udhëheqjes (pika 2.12; **Kapitulli III Standard VII.4**)
- gama e gjerë e mjediseve akademike dhe praktike në dispozicion, për të mbështetur të nxëniet e studentëve, përfshirë laboratorët cilësorë të gjuhës , Qendrën e Simulimit të luftës me teknologji të lartë dhe gamën e gjerë të burimeve mësimore (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi V.1**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme tashmë në proces:

- planet për përmirësimin e dy daljeve të emergjencës dhe sistemit të ngrohjes (pika 2.14; **Kapitulli III Standardi V.1**)

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Akademia përcakton qartë programet e saj prioritare të studimit, bazuar në nevojat profesionale të arsimit ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. **[57; 72]** Ajo ofron pesë programe kursesh, që nuk ofrojnë diploma, të cilat zgjasin nga katër deri në 10 muaj dhe përfshijnë: Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit; Kursin e Karrierës së Kapitenëve; Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm; Kursin e Lartë të Oficerëve; dhe Kursin e Lartë për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Kurset ofrojnë arsim profesional për personelin ushtarak në të gjitha nivelet dhe për drejtuesit civilë të përfshirë në funksionet e sigurisë dhe të mbrojtjes. **[25; 2]** Oferta akademike e Akademisë përputhet me procesin e Bolonjës dhe kreditet. Akademia i mbështet studentët që të angazhohen në programet e studimeve të ciklit të parë në bashkëpunim me institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri dhe jashtë saj. **[23; M5]** Në kohën e vizitës, 77 studentë ndiqnin studimet në vine Bachelor në fusha ushtarake ose sfera studimesh të lidhura me aspekte ushtarake në institucionet e arsimit të lartë në Turqi, Greqi, Itali, Gjermani, SHBA dhe Shqipëri. **[5 Neni 56; 2; 110; 19]** Akademia ka marrë miratimin gjithashtu nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të ofruar një program studimi Master Profesional në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe një Master të Shkencave në “Studimin e Sigurisë dhe Mbrojtjes” (Urdhër Nr. 396, datë 10.08.2011). **[2; 25; M2]** Akademia ka marrë miratimin gjithashtu për të ofruar një program të Doktoraturës në ciklin e tretë, në fushën e studimeve të sigurisë dhe të mbrojtjes, të licencuar nga Ministria e Mbrojtjes, sipas Urdhrit Nr. 502, datë 07.10.2011. Kurrikulat e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë janë riorganizuar, me qëllim përmbushjen e kërkesave të ligjit për arsimin e lartë nr. 80/2015, ofrimin e 60 krediteve, sipas kuadrit ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve), 120 ECTS dhe aplikimet janë dërguar për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kreditet janë të transferueshme dhe nxitet mobiliteti i studentëve. **[45; 55; M4; 6 Neni 46; 5 Neni 46, 57, 59, 2; 23]** **[Kapitulli I Standardi I.8; Kapitulli I Standardi I.10]**

3.2 Ofrimi i shërbimit akademik aktualisht është i kufizuar si pasojë e rishikimit të kërkesave nga Ministria e Mbrojtjes. Akademia nuk mund të ofrojë programe Bachelor, përkundrazi mbështet studimet e ciklit të parë të realizuar në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë në vend ose jashtë vendit. **[75; 101; 77; M3]** Në vitin akademik 2016-2017, janë raportuar 77 studentë që kryejnë studimet e tyre Bachelor në institucionet partnere jashtë vendit **[19; 106]** Stafi i Akademisë me kohë të plotë merr pjesë në zhvillimin e kurrikulës së ciklit të parë të disa prej institucioneve partnere, ku studiojnë studentë të AFA-së në ciklin Bachelor **[M5; 16; 41]** Në vendet pritëse janë caktuar atashetë ushtarake për të ndihmuar studentët që studiojnë në universitete jashtë vendit. Atashetë ushtarake ndihmojnë në menaxhimin e dokumentacionit të studentëve dhe përpilimin e raporteve për përparimin e studentëve, që i dërgohen Akademisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes. **[M3; M4]** Procedurat e ekuivalentimit të programeve të ciklit të parë kryhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[6]** **[Kapitulli I Standard I.7 dhe Kapitulli I Standard I.8]**

3.3 Akademia ka një shërbim të efektshëm në mbështetje të stafit dhe studentëve që dëshirojnë të përparojnë, për të studiuar ose ndërmarrë kërkim shkencor jashtë vendit. Provimi i gjuhëve të huaja ofrohet nga Qendra e Gjuhëve të Huaja, një njësi që i është bashkangjitur Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Qendra ofron kurse të gjuhëve të huaja për personelin ushtarak dhe civil në anglisht, frëngjisht, turqisht, greqisht, serbisht, gjermanisht, italisht dhe maqedonisht **[6 Nenet 36-37; 5 Neni 14; 20; 109; vizita në terren]**

Qendra përfshin Departamentin e Përkthimit dhe Testimit, puna e të cilit mbështet ecurinë e studentëve në studimet jashtë vendit. [17; 25; 109] Biblioteka e Qendrës së Gjuhëve të Huaja ofron 2.000 libra në mbështetje të procesit të mësimdhënies dhe ka materiale për të mbështetur studimin e pavarur. [M6; Vizita në terren] [Kapitulli I Standardi I.4]

3.4 Janë krijuar mekanizma dhe procedura të qarta për përgatitjen dhe publikimin e informacionit. Departamentet janë përgjegjëse për përgatitjen e informacionit të syllabusve bazuar në programet e miratuara. [38; 39; 40; 5; 6] Informacioni për programet e studimit bëhet publik me anë të materialit të shkruar (broshura), botimeve në internet, ndërmjet faqes së internetit të Ministrisë së Mbrojtjes ose botimeve ushtarake të shtypit. [81; 96; Faqja e internetit; 13] Promovimi i ofertës akademike të Akademisë kryhet nga Departamenti i Marketingut i Ministrisë së Mbrojtjes, i cili gjithashtu mban kontrollin e botimeve. [M6; 67] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi 1.6]

3.5 Politikat dhe procedurat e pranimit janë të qarta, dhe përcaktohen si pjesë e Rregulloreve të Akademisë. Pranimet bëhen në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes. [6 Neni 46] Stafi i qendrës së rekrutimit është përgjegjës për procesin e pranimit, përfshirë vlerësimin e dosjeve të aplikimit dhe intervistat në përputhje me kriteret e vendosura [M6; M4; 63; treguesit kryesorë të performancës] Kuotat për studentët e huaj janë hartuar dhe dërguar për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit [22; 6] [Kapitulli I Standardi I.1]

3.6 Kurrikula e programeve studimore bashkon aspektet e të nxëniet të bazuar në teori, praktikë dhe kërkim, të cilat mbështesin njohuritë dhe të kuptuarit akademik dhe praktik. [38; 39; 40; 88.1] Mësimi i gjuhëve të huaja kryhet në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Mbrojtjes. Programet janë të konceptuara për të integruar angazhimin e stafit ushtarak nga shtetet e tjera anëtare të NATO-s, për shembull, Kursi i Lartë i Studimeve për Sigurinë dhe Mbrojtjen që realizohet në anglisht dhe rekruton rreth 60 për qind të studentëve nga jashtë. [106; 107; 2] Diplomati dhe suplementet e diplomave ofrohen në gjuhën shqipe dhe angleze. [14; M6; 87] Planifikimi dhe zhvillimi i realizimit të kurrikulës përqendrohet në disiplina që lidhen me aspektet taktike, strategjike dhe operative të operacioneve dhe strategjisë ushtarake. [23; 102; 62] Politikat e vlerësimit janë në përputhje me standardet e ligjit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe standardet e marrëveshjes së standardizuar të NATO-s që zbatojnë një standard të përbashkët të NATO-s (STANAGs) [7; 50] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.10]

3.7 Programet e studimeve janë konceptuar që t'i përshtaten planit afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2020 dhe që të mbështesin zhvillimin e personelit. [72; 5; M5] Programet janë konceptuar për të përmbushur nevojat e kategorive të ndryshme të studentëve, duke përfshirë ato të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes dhe formimin e specialistëve të huaj ushtarakë. [25; 20] Përmbajtja e programeve të studimit është kryesisht e një natyre ushtarake, duke përfshirë operacionet ndërkombëtare dhe mbështet përgatitjen e atasheve dhe përfaqësuesve të caktuar në selinë ndërkombëtare të NATO-s dhe në Bashkimin Evropian dhe Kombet e Bashkuara [72; 15] Shërbimi gjithashtu i ofrohet personelit civil që punon për institucionet e qeverisë qendrore. [M3] Veprimtaria e Akademisë administrohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Sigurinë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake. [15.3 Kapitulli I. Standardi 1,4] [Kapitulli I Standardi I.2; Standardi I.3]

3.8 Sigurimi i cilësisë së shërbimit të ofruar kryhet në mënyrë të centralizuar nga Ministria e Mbrojtjes. Qendra e Mësimeve të Nxjerra në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes është përgjegjëse për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave, duke përfshirë reagimet e studentëve, shënimet e vëzhgimit të mësimdhënies, vlerësimet e programeve të brendshme dhe identifikimin dhe komunikimin e veprimeve të rekomanduara, për të mbështetur dhe siguruar cilësinë e shërbimit. **[42; 56; 44]** Qasja e vlerësimit të jashtëm ofruar nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra, pjesë e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së Ministrisë së Mbrojtjes, shërben për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit dhe realizimit të programeve nëpërmjet vlerësimit të paanshëm të shërbimit të ofruar dhe është një shembull i praktikës së mirë. **[12; 44; M3; M5]** Për të mbështetur menaxhimin e brendshëm të kurseve, Departamenti i Kurseve mbështet dhe monitoron ofrimin e kurseve në Akademi dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zhvillimit të kurseve dhe zbatimin praktik të proceseve të të nxënimit dhe trajnimit. **[6 Neni 44; 69] [Kapitulli I Standardi I.2]**

3.9 Programet e ofruara nga Akademia janë hartuar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe me Direktivat e Mbrojtjes dhe Politikat e Konceptit Strategjik për edukimin ushtarak të personelit të NATO-s **[5; M5; 3 Standardet I, I.4]** Diplomati dhe certifikatat e lëshuara janë të regjistruara nga Ministria e Mbrojtjes dhe përfshijnë fushat kryesore të studimit dhe kreditet, si dhe studime plotësuese, sipas rastit. **[87]** Akademia aktualisht nuk ofron programe ndërdisiplinore, por planifikon të ofrojë një diplomë të përbashkët me Universitetin e Tiranës dhe me Akademinë e Policisë, pas miratimit nga Ministria e Mbrojtjes **[M3; 72] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.10 Ngarkesa mësimore e fakultetit menaxhohet në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe kërkesat e Ministrisë së Mbrojtjes. **[46]** Personeli mësimdhënës gjithashtu pritet të angazhohet në aktivitete të tjera lidhur me prioritetet kërkimore ose ushtarake, në përputhje me direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe administrimin e kurseve dhe kërkimin shkencor. **[88.3; 26; 27; M5]** Buxheti alokohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe përfshin kostot e realizimit të kurrikulës dhe kërkimit të miratuar. **[28; M3; M5] [Kapitulli I Standardi I.5]**

3.11 Studentëve u ofrohen informacione të qarta për kurset. Informacionet për kurrikulën dhe literatura mbështetëse janë të aksesueshme nga studentët në mënyrë elektronike, si dhe me anë të burimeve të identifikuar në katalogët e kurseve. Doracakët e kursit japin detaje mbi rezultatet e të mësuarit dhe përmbajtjen e kursit. **[25; 88]** Manuali i Studentit përfshin kriteret e pranimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës, dhe Programi i Orientimit përcakton objektivat e kualifikimit dhe përmbajtjen e kurseve. **[62; 100; M4; 38; 39; 40] [Kapitulli I Standardi I.6]**

3.12 Programet e studimeve të ciklit të dytë janë konceptuar për të mbështetur prioritetet e edukimit dhe kërkimit shkencor të Forcave të Armatosura dhe institucioneve të tjera të sigurisë. **[53; 73]** Veprimtaria e kufizuar kërkimore e ndërmarrë nga stafi akademik përqendrohet në mbështetjen e zhvillimit të programit. Pjesa më e madhe e mësimdhënies (70 për qind) mbulohet nga stafi akademik i fakultetit me kohë të plotë dhe plotësohet stafi i huaj dhe shkëmbimet me institucionet partnere në vendet anëtare të NATO-s dhe Evropë. Kjo përfshin Qendrën Marshall, Shkollën Ndërkombëtare të Hamburgut, Universitetin La Sapiensa dhe Qendrën e Studimeve të Lartë të Mbrojtjes në Romë. **[41; 88.3; 49]** Për kurrikulat e ciklit të dytë dhe të tretë, Akademia angazhon përfaqësues të fushave të sigurisë dhe mbrojtjes të marrë nga institucionet e vendeve anëtare të NATO-s. **[42; M3]** Akademia

aktualisht nuk drejton një njësi kërkimore, dhe kjo çon në mundësi të kufizuara për stafin lidhur me angazhimin e tyre në kërkim shkencor, për t'i ndihmuar në mësimdhënien e tyre dhe në mbikëqyrjen e ardhshme të studentëve të programeve master dhe doktoraturës, që përbën një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** si një prioritet të lartë që Akademia të kërkojë të ringrejë një njësi kërkimore, për të mbështetur zhvillimin dhe realizimin e arsimit të lartë.

3.13 Nuk kanë pasur regjistrime të reja në programet e studimeve të ciklit të dytë në AFA që prej vitit 2013, **[2]** për shkak të ndryshimeve në ligjin për arsimin e lartë dhe nevojën për të përditësuar programet e tyre në përputhje me kërkesat e tij (pika 3.1). Realizimi i programit të ciklit të tretë është pezulluar që prej vitit 2015, pasi veprimtaria e Këshillit të Profesorëve nuk ka përmbytur dispozitat e ligjit të ri për arsimin e lartë në Shqipëri (shih pikën 1.10). **[104; M3, M5; M6]** Aktualisht, Ministria e Mbrojtjes nuk e lejon Akademinë të ofrojë programe të plota të arsimit të lartë në nivelin universitar ose pasuniversitar dhe personeli nuk është në gjendje të zhvillojë ose të vlerësojë programet, ose t'i përqendrojë aktivitetet kërkimore në zgjerimin e studimeve pasuniversitare, të cilat Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i ka identifikuar si një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** si një prioritet të lartë identifikimin e shërbimit të duhur të arsimit të lartë për realizim e programeve bazuar në validimin e kurseve praktike për programet e studimit me diplomë ose me certifikatë. **[Kapitulli I Standardi I.9]**

3.14 Kurset e ofruara ofrojnë qasje praktike në njohuritë teorike, dhe përfshijnë tematika kombëtare dhe ndërkombëtare të rëndësishme për fushën. **[38; 39; 40; 88; 107; 25; M5]** **[Kapitulli I Standardi I.12]** Strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënies përfshijnë seminare, punë grupi, ushtrime praktike dhe planifikim, studime të rasteve dhe kërkime për çështje aktuale. **[44; M4; M5]** Studentët i vënë në praktikë njohuritë e tyre në kontekstin e operacioneve ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Qendra e simulimit ofron një mjedis mësimor të bazuar në teknologji, i cili mbështet stërvitjen praktike. Skenarët iu kërkojnë studentëve të marrin vendime strategjike dhe të vlerësojnë ndërlikimet, që, siç përmendet në pikën 2.13, përbëjnë praktikë të mirë. **[102]** Amfiteatri i kinemasë së Ministrisë së Mbrojtjes, qendra sportive dhe muzeu janë në dispozicion për të përmbytur nevojat e mësimdhënies, sipas kërkesës. **[Vizita në terren 109]** **[Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.15 AFA nxit pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet kulturore. **[M5]** Ofrohen një sërë aktivitetesh ekstrakurrikulare për studentët, përfshirë sporte dhe vizita jashtë shtetit, dhe atje ku është e përshtatshme ofrohen kurse të gjuhëve të huaja dhe të artit për pjesëtarët e familjeve të studentëve. **[M4; M5; 61]** **[Kapitulli I Standardi I.11]**

3.16 Akademia ka procese të qarta për të siguruar menaxhimin e shërbimit të tij. Qasja e vlerësimit të jashtëm e ofruar nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra shërben për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit dhe realizimit të programeve, nëpërmjet vlerësimit të paanshëm të ofrimit të programeve dhe është një shembull i praktikës së mirë. Stafi akademik ka mundësi të kufizuara për t'u angazhuar në kërkim shkencor, që do të mbështeste studimet pasuniversitare, si dhe zhvillimin e programeve të reja, me qëllim përmbyturjen e ekspertizës së ardhshme ushtarake, që përbëjnë dobësi. Rekomandohet identifikimi i shërbimit të duhur të arsimit të lartë për validim, në bazë të dispozitave aktuale dhe lidhjeve me kurrikulën, dhe ringritjes së një njësie kërkimore, për mbështetjen e arritjeve pasuniversitare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri ndonjë pohim për këtë fushë vlerësimi.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- qasja e jashtme e ofruar nga Qendra e Mësimeve të Nxjerra shërben për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit të programit dhe përcjelljen, nëpërmjet vlerësimit të paanshëm të shërbimit të ofruar (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi I.1 dhe Kapitulli I Standardi I.10**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mundësi të kufizuara për stafin që të angazhohet në kërkim shkencor, gjë që do të mbështeste mësimdhënien e tyre dhe monitorimin e ardhshëm të studentëve të programeve Master dhe Doktoraturë (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.9**)
- Akademia nuk ofron programe të plota të arsimit të lartë dhe nuk mund të zhvillojë dhe të vlerësojë shërbimin e ofruar ose të përqendrojë veprimtarinë kërkimore në zgjerimin e studimeve pasuniversitare (pika 3.13; **Kapitulli I Standard I.8 dhe Standardi I.9**)

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Akademia të synojë të ringrejë një njësi kërkimore për të mbështetur zhvillimin dhe ofrimin e arsimit të lartë (Prioritet i lartë) (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.9**)
- Akademia të identifikojë shërbimin e duhur të arsimit të lartë për ofrimin e tij bazuar në validimin e kurseve aktuale lidhur me praktikën për programet e studimeve me diplomë ose certifikatë (prioritet i lartë) (pika 3.13; **Kapitulli I Standard I.9**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Deri më sot Akademia ka mbështetur mbrojtjen e 147 tezave të Doktoraturës në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. **[2]** Megjithatë, që prej vitit 2014, studimet e Doktoraturës u pezulluan për shkak të riorganizimit, dhe aktualisht Akademia nuk ka mundur të arrijë një kuorum të stafit akademik me titullin Profesor. **[103]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mësoi se po bëheshin përpjekje që procesi të zhvillohej në bashkëpunim me universitetet e tjera, por ende nuk kishte plane konkrete. **[M3]** Siç përshkruhet në pikën 3.1, Akademia ka ofruar një sërë programesh studimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, përfshirë Master Profesional, Master të Shkencave, Master Ekzekutiv si dhe studime Doktorature. Për të mbështetur studentët në studimet e tyre aktuale dhe të ardhshme, Qendra e gjuhëve të Huaja ofron kurse në gjuhën angleze, gjermane, italiane, frënge, maqedonase dhe greke. Megjithatë, gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni se programet të nivelit Master dhe Doktoraturë janë aktualisht të paakredituara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nuk po zhvillohen. **[2; M2; M3]** Në veçanti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se ndërmjet viteve 2010 dhe 2016, 73 studentë të doktoratës nuk kishin arritur të përfundonin programet e tyre të studimit. Duke qenë se studentët i kanë ndërprerë studimet e tyre që prej vitit 2014 dhe siç parashihet në pikën 1.10, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i mendimit se kjo situatë përfaqësonte një dobësi madhore. Një rekomandim në pikën 1.10 sugjeron që Akademia të punojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për të hartuar strategji në mbështetje të studentëve të ciklit të tretë që të përfundojnë programin e tyre. **[3 fq.25, - Ref 3.a, 4. J - Lista e programeve të ofruara dhe koncepti i edukimit ushtarak të Forcave të Armatosura; 3 f.24-25; 104]** **[Pranimi, Përparimi, Njohja dhe Certifikimi i Studentëve 1.4] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 Akademia koordinon në mënyrë të efektshme punën e stafit akademik për të siguruar koherencë të përmbajtjes, duke përfshirë kapacitete të mjaftueshme për realizimin e trajnimit praktik, nëpërmjet ushtrimeve praktike, mësimëve praktike dhe analizës së betejës (Qendra e Simulimit) në vend dhe në të gjithë territoret aleate. **[3 fq.25 - Ref 4.a - Politikat dhe procedurat e mësimdhënies dhe mësimnxënies; 3 fq. 24-25]** Siç është vërejtur në pikat 2.10 dhe 2.13, Akademia përdor një sërë burimesh të cilësisë së mirë, për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien, që përfshijnë: bibliotekat, muzeun ushtarak, auditorin, kinemanë, palestrën dhe një sërë objektesh sportive për stërvitjen e studentëve. Biblioteka kryesore e Akademisë ka 7,300 tituj, 35,000 libra, 2,264 buletine dhe revista, 117 disertacione dhe katër salla studimi. Biblioteka është e hapur ndërmjet orës 8 paradite dhe 8 pasdite dhe ofron literaturë mbështetëse, përfshirë burimet e bibliotekave elektronike për çdo program studimi. **[3 f.25; 48] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.3 Ka procedura të efektshme për menaxhimin e vlerësimit. Marrëveshjet e provimit dhe testimi miratohen nga strukturat akademike konsultative dhe bëhen publike për personelin akademik dhe studentët, nëpërmjet rregulloreve aktuale në një dosjeje elektronike që disponohet për të gjithë personelin. **[5; 6; 7]** Rregulloret e vlerësimit respektojnë si privatësinë, ashtu edhe anonimitetin. Studentët kanë të drejtën e plotë të ankimit për të gjitha rezultatet e provimeve, të vlerësuara nga departamentet në përputhje me statutin, rregullat e brendshme dhe rregulloret e vlerësimit. **[44; 90; 62]** Rezultatet e provimeve jepen në mënyrë individuale, duke respektuar parimin e konfidencialitetit për të gjithë studentët dhe rezultatet e provimeve publikohen në kohë në oraret e dakorduara. Në takimet me personelin është pohuar që shumë pak studentë i ankimojnë notat. **[50; M6] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.4 Performanca akademike e stafit vlerësohet në baza vjetore nga departamenti përkatës. **[49]** Studentët marrin pjesë në vlerësimin e pedagogëve dhe programeve me anë të anketimeve dhe pyetësorëve të organizuar nga Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe nga

departamentet përkatëse. [65; 66] Programet e studimeve përmirësohen në baza vjetore, mbështetur në reagimet e stafit akademik dhe studentëve. Gjatë periudhës maj-qershor të çdo viti akademik bëhet një vlerësim i programeve studimore. Cilësia e programeve vlerësohet nga një sërë statistikash, duke përfshirë edhe punësimin e të diplomuarve. Të diplomuarit e Akademisë shërbejnë rregullisht në komandat e NATO-s dhe në selinë ushtarake, si dhe në postet strategjike dhe operacionale në Shqipëri. [77; 49] **[ESG 1.9 Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve]** [Kapitulli I Standardi II.3]

4.5 Nivelet e personelit janë të përshtatshme për të përmbushur kërkesat mësimore dhe administrative të Akademisë. Për vitin akademik 2016-2017, Akademia ka pasur 71 punonjës akademikë dhe 37 punonjës administrativë të përkushtuar, me qëllim mbështetjen e të nxënit e studentëve, duke përfshirë 63 akademikë me kohë të plotë me kualifikime pasuniversitare. [2; 3 fq.25-26; 103; 38] Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i stafit akademik janë trajnuar jashtë vendit, për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe përvojën ndërkombëtare. [42; 2; 103] Departamenti i Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore zhvillon kurse didaktike për mësuesit e rinj lidhur me metodat e reja të mësimdhënies. [18; 42] Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, secili pedagog në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes i paraqet leksionet e tij/saj në departamentin përkatës, për të diskutuar dhe shkëmbyer mendime para se leksioni t'u jepet studentëve. [42; 27; M5] I gjithë personeli akademik, mësimdhënës, shkencor dhe administrativ angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e të nxënit në të gjitha programet e studimit. [83; 103] **[ESG 1.3 Të Mësuarit me në qendër Studentin, Mësimdhënia dhe Vlerësimi]** [Kapitulli I Standardi II.4]

4.6 Departamenti është njësia bazë e mësimdhënies/kërkimit dhe përfshin fusha homogjene dhe ndërdisiplinore të studimit. Çdo departament organizohet në grupe mësimore të identifikuara në strukturën akademike, por Akademia nuk ka një qendër kërkimore të posaçme. [M2; 103; 18] Akademia punon me Qendrën e Kërkimit të Doktrinës, një qendër e jashtme e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila përgatit materiale, kërkimin shkencor, manuale dhe mësim të nxjerra në interes të Forcave të Armatosura, duke përfshirë vlerësimin e programeve të ofruara. [42; 44; M3] Çdo departament promovon dhe koordinon aktivitetet e mësimdhënies dhe kërkimit, duke respektuar lirinë akademike të stafit. [M3; M5; 53; 54] Departamentet analizojnë rezultatet e grupeve kërkimore dhe bien dakord për vazhdimin ose përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. [6; 41] Burimet e financimit të kërkimit janë të kufizuara, dhe stafi akademik i ka arritur rezultatet e kërkimit, nëpërmjet studimit individual dhe bashkautorësisë. [53; 3 fq.27; M3; M5] [Kapitulli II Standardi I.1]

4.7 Akademia mund të mbështesë disa grupe të reja kërkimore shkencore dhe produktet e tyre, për shembull në partneritet me Qendrën e Kërkimit të Doktrinës rezultatet e të cilëve publikohen në shtyp, në revista dhe në broshura të konferencave. [53; 54; M3] Akademia gjithashtu bashkëpunon me një sërë universitetesh dhe qendra rajonale në Ballkan, për shembull me Universitetin e Tiranës. [16; 75] Në bashkëpunim me TRADOC, një revistë ushtarake, publikohet një botim mujor teoriko-shkencor. Bashkëpunimi ndërmerret gjithashtu me qendrat ndërkombëtare të studimit kërkimor, duke përfshirë: Qendrën George Marshall në Gjermani dhe Kolegjin e NATO-s në Itali. [3 fq.27; 76; 16; M5] [Kapitulli II Standardi I.2] Akademia ka bashkëpunuar me Komandat e NATO-s për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për sa i përket çështjeve operacionale që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e “të mësuarit në operacione”. [73; 72; 16] Një rrjet në internet ka mundësuar pjesëmarrje të koordinuar në konferenca dhe botime shkencore. [M3; M5] Për shembull, Akademia ka kontribuar në një projekt për hartimin e “Strategjisë së Forcave Ajrore të NATO-s” dhe është siguruar mbështetje e kufizuar për stafin akademik që të marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit. [53; 73; 54; 82; M3] Në janar të vitit 2017, Akademia ka marrë pjesë në dy aktivitete shkencore: “Ligji Ndërkombëtare Humanitare” dhe “Trajtimi i Luftëtarëve të Huaj”, organizuar në bashkëpunim me Institutin

për Ligjin Ndërkombëtar Humanitar të San Remos, Qendrën Marshall në Gjermani dhe Qendrën për Studimet e Larta të Mbrojtjes, Itali. Rezultatet nga këto aktivitete kanë ndikuar në vendimmarrjen e institucioneve kombëtare dhe të NATO-s, me qëllimin krijimin e Qendrës së Ekselencës së NATO-s në Shqipëri, për trajtimin e luftëtarëve të huaj. [72; M2; M3; 49] Në mars të vitit 2016, tre Profesorë Akademikë morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Sigurinë në Stamboll, Turqi, dhe stafi i Akademisë ka botuar në revistat shkencore ndërkombëtare përfshirë: “Trashëgimia” botuar nga Universiteti i Strugës, Maqedoni; “Çështjet e sigurisë” botuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. [3 fq.27-28; M4; 55; M5] [Kapitulli II Standardi I.3]

4.8 Çdo departament akademik gjatë ciklit të planifikimit akademik vjetor përgatit një plan veprimtarish shkencore, për t'i dhënë përparësi fokusit të vet të kërkimit. Planet përfshijnë të paktën një konferencë kërkimore shkencore për stafin akademik dhe lektorët e ftuar [53; 54] Sipas kërkesës Akademia ofron ekspertizë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mundi gjente evidenca të kufizuara për të vërtetuar që Akademia ka një plan kërkimor të përcaktua dhe të priorizuar, siç tregohet në pikën 3.12. [3 f.28; 53] Rreth 80 për qind e stafit akademik kanë përfunduar studimet ose janë kualifikuar në akademi dhe universitete në vendet Perëndimore. Prioritetet e kërkimit janë pjesë e planit kombëtar të zhvillimit për Forcat e Armatosura dhe objektivat janë të standardizuara në lidhje me standardet e NATO-s (NATO STANAGs), që rrjedhin nga Akti i Komandës Strategjike të NATO-s. Në diskutim me stafin e Akademisë u bë e qartë se prioritetet e kërkimit shkencor ishin të pazhvilluara, pasi njësi kërkimore u pezullua në pritje të riorganizimit nga Ministria e Arsimit. [M3; M5; 54] [Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5]

4.9 Akademia është e përkushtuar në hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale dhe kombëtare të kërkimit shkencor si pjesë e punës së saj për të siguruar përputhjen me standardet e NATO-s. Anëtarësimi në NATO siguron përqendrimin te procedurat dhe standardet, trajnimi, botimi dhe shkëmbimi i përvojës ndërkombëtare. [72; 73; M2; M3] Personeli akademik është i angazhuar në aktivitete shkencore në kuadrin e bashkëpunimit me institucionet arsimore në vend dhe me akademitë e NATO-s jashtë shtetit. [54; M3; M5] Përveç kësaj, Akademia fton lektorë të kualifikuar nga vendet e NATO-s, për të marrë pjesë në kursin e lartë për Siguri dhe Mbrojtje, një kurs i cili është zhvilluar tetë herë dhe ka tërhequr studentë joshqiptarë nga shërbimet e tjera të armatosura. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni se në programet e Akademisë kanë dhënë mësim 38 lektorë të huaj [54; M4; 95; M5] [Kapitulli II Standardi I.6]

4.10 Akademia, në përmbushjen e kriterëve ligjore për gradat shkencore dhe titujt akademikë, nxit anëtarët e fakultetit të botojnë në revista shkencore, kryesisht në vendet fqinje dhe më gjerë, për shembull në Itali, Kosovë dhe Maqedoni. Megjithatë, nuk u mundësuan detaje në lidhje me përqindjen e stafit të përfshirë në mënyrë aktive në botimin e rezultateve të kërkimit të tyre. [54; 53; M3] Akademia në bashkëpunim me Qendrën e Kërkimit të Doktrinës përgatit dhe boton revistën “Teorike Shkencore”. [54] Struktura kërkimore e Akademisë aktualisht është e pazhvilluar dhe prandaj veprimtaritë kërkimore janë të kufizuara dhe nuk lejojnë vlerësimin e thellë të pikave të forta dhe të dobësive të kërkimit. [73; M2; M3] Infrastruktura e kufizuar e Akademisë për staf kërkimor nuk ka qenë në gjendje t'i japë përparësi kërkimit shkencor dhe të vlerësojë rezultatet në projektet kërkimore, gjë që përbën një **dobësi**, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon si një prioritet të lartë që Akademia të zhvillojë një plan kërkimor, i cili të ndërtojë kapacitetet kërkimore të stafit, të promovojë rezultatet e kërkimit, të menaxhojë shpërndarjen dhe të vlerësojë performancën e kërkimit. [M3; M5] [Kapitulli II Standardet I. 1-8]

4.11 Përgjegjësitë për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit përcaktohen në statutin dhe rregulloret. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë aspekt të praktikës së mirë. Dobësitë u identifikuan në infrastrukturën e kufizuar të

Akademisë për staf kërkimor, e cila nuk ka qenë në gjendje t'i japë përparësi projekteve kërkimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Akademia të punojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për të hartuar një plan kërkimor, i cili të ndërtojë kapacitetet kërkimore të stafit, të promovojë rezultatet e kërkimit, të menaxhojë shpërndarjen dhe të vlerësojë performancën e kërkimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri ndonjë pohim.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- infrastruktura e kufizuar e Akademisë për personelin kërkimor shkencor, që nuk ka qenë në gjendje t'i japë përparësi kërkimit shkencor dhe të vlerësojë rezultatet në projektet kërkimore (pika 4.10; **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Akademia të zhvillojë një plan kërkimor shkencor, që të ndërtojë kapacitetin e stafit të kërkimit shkencor, të promovojë rezultatet e kërkimit, të menaxhojë shpërndarjen dhe të vlerësojë performancën e kërkimit shkencor (Prioritet i lartë) (pika 4.10, **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri ndonjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Për studentët e rinj ka procedura të qarta për pranimin dhe regjistrimin. Akademia ka hartuar politikën e saj afatmesme të pranimit të studentëve, si pjesë e Planit të Zhvillimit Strategjik, që të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore. [72] Kuadri ligjor i Akademisë përcakton procedurat e kërkuara të regjistrimit dhe kriteret për pranimin e studentëve në kurset e trajnimit, së bashku me kriteret për aplikantët në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Mbrojtjes [5; 62] Akademia bashkëpunon me Qendrën e Rekrutimit të Personelit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe harton plane bazuar në nevojat arsimore ushtarake dhe mban Komisionin që kryen testimin e kandidatëve. [63; M6; M4] Procedurat e rekrutimit, së bashku me intervistat e kandidatëve, ndërmerren nga Komisioni i Pranimeve, i cili përfshin përfaqësues nga Akademia. Çdo rast i pranimit të ankesave shqyrtohet nga një komision ad hoc, vendimet e të cilit janë përfundimtare. [M4; M6] Në kohën e vizitës së vlerësimit, nuk po rekrutohej asnjë student në nivelin pasuniversitar. [M1; M2] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri në dukje se aktualisht mekanizmat për të mbështetur studentët e Doktoraturës, që të përfundojnë programin e tyre, janë pezulluar, dhe siç u përmend në pikën 1.10, ai identifikoi një dobësi në fushën e menaxhimit të mësimxënies dhe mbështetjes së studentëve. [ESG Standardi 1.3 Të Nxënit me në Qendër Studentin, Mësimdhënia dhe Vlerësim] [Kapitulli I Standardi III]

5.2 Administratori i kursit nga secili departament është përgjegjës për dokumentacionin e pranimeve dhe regjistrimet e studimeve të mëparshme dhe studimeve në vazhdim të kandidatëve. [6 Neni 45] Kopjet e dosjeve të studentëve dhe dokumentacioni i ecursisë mbahen dhe ruhen nga Sektori i Personelit. Të dhënat hidhen në regjistra të veçantë, që mbështeten në mënyrë elektronike. [6 Neni 42; M6] Komunikimet e brendshme dhe të jashtme ruhen nëpërmjet përdorimit të adresave elektronike nga stafi dhe studentët, regjistruar në dosjet elektronike dhe dosjet fizike. [M4; M5] [Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.3]

5.3 Ka mekanizma të përshtatshëm për dhënien e informacionit. Informacionet për pranimet dhe kurset e studimit u vihen në dispozicion kandidatëve, nëpërmjet faqes së internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, fletëpalosjeve, materialeve në letër, duke përfshirë katalogun e kurseve dhe takimet me stafin e Akademisë. [59; 81; 25; M4] Akademia bashkëpunon me Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, për të realizuar fushata marketingu për programet universitare së bashku me institucionet universitare dhe institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. [M6] Studentët e huaj mund t'i ndjekin kurset në përputhje me marrëveshjet e partneritetit; për vitin akademik 2016-2017 vetëm pesë studentë me shtetësi të huaj (nga 17 studentë nga institucionet partnere) kanë ndjekur kurset e Akademisë. [2] Raporti i stafit akademik me kohë të plotë me studentët është një anëtar i stafit për çdo gjashtë studentë, që plotëson standardin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. [2; 103] [Kapitulli I Standardi III.1, Kapitulli I Standardi III.3]

5.4 Stafi i Akademisë siguron në mënyrë të efektshme mbështetje dhe orientim për studentët. Departamenti i kurseve ofron udhëzime dhe këshillime për studentët, duke filluar nga regjistrimi deri në diplomim. [6 Neni 45] Çdo departament cakton një lektor, pedagog përgjegjës për një grup studentësh, që monitoron dhe mbështet përparimin dhe ofron mbështetje këshillimore dhe udhëzime për legjislacionin e Akademisë, kurrikulat e kursit dhe kriteret e vlerësimit të bazuar në kompetenca. [60; 100; 62] Informacioni i kursit dhe literatura shkëmbehet në mënyrë elektronike ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, me anë të një sistemi të përbashkët të skedaresh, ndërsa informacioni më i klasifikuar sigurohet nëpërmjet sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes. [M5; M4] Kurset ofrojnë orientim në mbështetje të aftësive të shkrimit, por studentëve nuk u ofrohet asnjë shërbim sistematik i rritjes së aftësive akademike. [M6] Akademia ofron orientime për mobilitetin e studentëve, duke përfshirë mundësitë për të studiuar në institucionet partnere të arsimit të lartë dhe shkollat e

NATO-s, me qëllim mbështetjen e zhvillimit individual të karrierës. [55; 16; M4; M5] Procedurat për transferimin e studimeve dhe ecurinë ndërmjet programeve dhe cikleve përcaktohen në kuadrin ligjor të Akademisë. [6 Neni 73] Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur raste të transferimit të studimeve të pjeshme. [86; 2] [Kapitulli I Standardi III.3; Kapitulli I Standardi III.6]

5.5 Ka politika dhe procedura për të siguruar aksesin e grupeve të identifikuara të pakicave dhe për të mbështetur përvojën më të gjerë të studentëve. Si një institucion ushtarak, Akademia nuk ka procedura për pranimin e studentëve me aftësi të kufizuara dhe një numër ndërtesash nuk janë të aksesueshme për studentët me lëvizshmëri të kufizuar. [3 Kapitulli I, Standardi III.4; M5; 109] Akademia ka një politikë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve romë dhe ballkano-egjiptianë që kanë kualifikim të arsimit të lartë dhe që plotësojnë kërkesat e pranimit dhe janë të pranueshëm me anët të punës në shërbimet ushtarake. [99] Aktualisht Akademia nuk ofron asnjë studim me kohë të pjeshme. [25; 81; M3] Në kampus ka ambiente sportive, që përfshijnë një qendër sportive të mbyllur, një palestër, fushë volejboli dhe ambiente për xhudo. Ka edhe fushë futbollit të hapur. Studentët nxiten në mënyrë aktive për të marrë pjesë në sporte dhe për të mbajtur trupin në formë. [Vizita në terren; 77; 66] [Kapitulli I Standardi III.4]

5.6 Akademia siguron burime dhe ambiente të përshtatshme studimi. Janë në dispozicion libra dhe literaturë në disa gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe, angleze dhe frënge, nëpërmjet bibliotekës kryesore të Akademisë dhe bibliotekës së Qendrës së Gjuhëve të Huaja. [vizita në terren; 109] Të dy bibliotekat ofrojnë libra, tekste studimore, revista, leksione të shtypura, teza diplomimi, studime rastesh, disertacione dhe fletëpalosje, që lidhen me programet e studimit. [29; vizita në terren; 109; M5; M6] Puna akademike dhe materialet kërkimore botohen nga Sektori i Publikimeve të Qendrës së Doktrinës dhe janë të disponueshme nga Biblioteka e Akademisë. [M6] Stafi dhe studentët kanë karta regjistrimi dhe mund të hyjnë në bibliotekë nga në orarin 08.00-20.00 të ditëve të javës. Ata gjithashtu kanë akses në materiale interneti me anët të lidhjeve në faqet e tjera të internetit të sigurua nga kompjuterat e bibliotekave. [vizita në terren; M6] Buxheti i Akademisë përfshin fonde për pasurimin e bibliotekës, bazuar në nevojat dhe kërkesat e departamentit. [28; 78; M5; M6] Aktualisht biblioteka e Akademisë nuk ka ndonjë tekst ose burime të veta online. Stafi akademik përdor burimet në internet të NATO-s në një sistem të përbashkët skedarësh, dhe mund të arrihet akses në materialet strategjike, nëpërmjet fondit të Ministrisë së Mbrojtjes. [M5] Për të përmirësuar disponueshmërinë e burimeve për studentët, stafi i bibliotekës së Akademisë po punon në një projekt institucional, për digjitalizimin e stokut të bibliotekës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se Akademia e njej nevojën për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të internetit të ofruara për studentët dhe stafin, i cili mbështetet nga një program për digjitalizimin e burimeve. [Vizita në terren] [Kapitulli I Standardi III.5]

5.7 Akademia nxit pjesëmarrjen e studentëve në komisionet e saj. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik dhe në Këshillin e Etikës. [5; 9; 67] Anëtarët e studentëve të Senatit Akademik zgjidhen në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë nr. 80/2015, dhe mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes. [5 Neni 24; 64; M4] Studentët morën pjesë në hartimin e dokumentit të vetëvlerësimit dhe marrin pjesë aktive në procedurat e sigurimit të cilësisë në Akademi, nëpërmjet dhënies së feedback-ut dhe nëpërmjet diskutimeve në një sërë nivelesh me stafin. [5 Neni 66; 68; 80] Kur studentët kanë shqetësime, këto mund të ngrihen drejtpërdrejt nëpërmjet pedagogut përgjegjës të kursit/grupit ose nëpërmjet stafit kryesor në nivel departamenti dhe fakulteti. [62; 66; M4] [Kapitulli I Standardi III.7]

5.8 Kërkesat strehimore, sociale dhe kulturore të studentëve janë të parashikuara nga Akademia. Për studentët që nuk jetojnë në afërsi, Akademia ka një politikë mbështetëse për ofrimin e strehimit në kampus, një infrastrukture sociale dhe ambiente për mensë. [Vizita në terren 32; M4] Akademia, siç përshkruhet në pikën 5.5, ofron një sërë objektesh sportive

nëpërmjet qendrës së saj sportive. Për të mbështetur më tej cilësinë e jetës për stafin dhe studentët, Akademia gjithashtu ofron një amfiteatër kinemaje dhe një sërë aktivitesh kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si kampionatet e shahut, futbollit dhe volejbollit, garat e qitjes dhe pjesëmarrjen në maratonë. Janë organizuar edhe vizita në muze dhe vende kulturore. **[M4; M5; 77] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Gjithashtu funksionojnë një qendër shëndetësore, një njësi e specializuar e psikologjisë, si dhe një qendër fizioterapie bashkangjitur palestrës. **[32; M4]** Studentëve u kërkohet t'i nënshtrohen testimi vjetor të formës fizike, dhe, çdo trajtim mjekësor që nuk mund të sigurohet nga qendra shëndetësore, realizohet në bashkëpunim me Spitalin Ushtarak Qendror në Tiranë. Ky i fundit kryen kontrole të plota mjekësore për studentët dhe ofron trajtim falas për stafin dhe studentët. **[3 Kapitulli I, III.8; vizita ne terren] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.10 Qendra e Rekrutimit të Personelit të Akademisë mban të dhëna statistikore pëe punësimin e të diplomuarve të saj, që pothuajse të gjithë janë personel ushtarak në shërbim. **[2]** Në përputhje me legjislacionin ushtarak në fuqi, 100 për qind e studentëve shqiptarë, që mbarojnë kurset e Akademisë, punësohen në organizatën ushtarake Shqiptare. Rekomandimet e bëra nga Akademia merren në konsideratë, kur studentët rekrutohen në vende të reja pune, veçanërisht në raste kur kërkohen nivele të larta të aftësive profesionale. Alumni mbajnë kontakt me Akademinë dhe shpesh kthehen për të përfunduar studime të mëtejshme dhe kurseve të trajnimit. **[61; 64; M3; M4]**

5.11 Akademia është e përkushtuar që t'i përmbush nevojat e studentëve të saj, gjë që e kryen, duke angazhuar studentët në organet vendimmarrëse të Akademisë, duke siguruar mësimdhënie, burime, tutorim dhe mbështetje. Akademia siguron ambientet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare në kampus për studentët e vet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Akademia dhe stafi i saj kanë identifikuar nevojën për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të internetit të ofruara për studentët dhe stafin, që mbështetet nga një program për digjitalizimin e burimeve të bibliotekave. Nuk janë identifikuar shembuj të praktikës së mirë, dobësi dhe nuk janë dhënë rekomandime për këtë fushë vlerësimi.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme tashmë në proces:

- nevoja për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe shërbimeve në internet të ofruara për studentët dhe stafin, që mbështetet nga një program për ruajtjen digjitale të burimeve (pika 5.6, **Kapitulli I Standardi III.5**).

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Nr. i dokumenteve
1. Deklarata mbi vërtetësinë e informacion (Shqip)
2. Të dhëna të përgjithshme për profilin
3. RAPORT VETEVLERËSIMI
4. RVB ne gjuhën shqipe (Dokumenti i Vetëvlerësimit në shqip)
5. Statuti
6. Rregulloret
7. Rregulloret e vlerësimit
8. Rregullorja e Senatit
9. Kodi i Etikës
10. Plan Veprimi
11. Urdhër Komandant/Rektor për procesin e akreditimit (Shqip)
12. Fusha 1. Politikat dhe procedurat e Sigurimit të Cilësisë. (Shqip)
13. Politikat dhe procedurat e informimit publik (Shqip)
14. Strategjia e Zhvillimit Institucional (Shqip)
15. Strategjia përbashkët/ndërkomb. (Shqip)
16. Cooperation Agreements; examples for each faculty.doc (Marrëveshjet e Bashkëpunimit, shembuj për çdo fakultet)
17. Organisational Structure and ChNeni docx (Struktura Organizative dhe Organigrama)
18. The distribution structure of the academic staff in the HEI units.docx (Struktura e shpërndarjes e stafit akademik në njësitë e IAL-së)
19. LIST OF STUDENTS STUDYING ABROAD.xlsx (Lista e studentëve që studiojnë jashtë vendit)
20. STANAG 6001 Edt. 4 LANGUAGE PROFICIENCY LEVELS.pdf (Nivelet e kompetencës së gjuhës)
21. Raport vetëvlerësimi 2010 (Shqip)
22. Miratimi i kuotave për programet e studimit (Shqip)
23. Katalogu i programeve institucionale (Shqip)
24. Katalogu i programeve të studimit (Shqip)
25. Courses catalogue.pdf (Katalogu i kurseve)
26. Human resource management policies and procedures.doc (Procedurat dhe politikat e politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore)
27. Key performance indicators of academic staff.doc (Treguesit kryesorë të performancës së stafit akademik)
28. Financial management policies and procedures for allocation, budget control and internal audit.doc (Procedurat dhe politikat e menaxhimit financiar për alokimin, kontrollin e buxhetit dhe auditimin e brendshëm)
29. Information systems to support teaching and learning.doc (Sistemet e informacionit që mbështesin mësimdhënien dhe mësimnxënien)
30. Information systems to support institutional management.doc (Sistemet e informacionit që mbështesin menaxhimin institucional)
31. Information management policies and procedures.doc (procedurat dhe politikat e menaxhimit të informacionit)
32. Management policies of accommodation and other physical resources.doc (Politikat menaxheriale të strehimit dhe të burimeve të tjera fizike)
33. Udhëzimi i MM Nr. 8 date 20.05.2013 'Për kriteret e përzgjedhjes së pers. Pedagogjik (Shqip)
34. Plani vjetor i arsimimit/trajnimimit të personelit (Shqip)
35. Përmbledhje e investimeve financiare të planifikuara
36. Tabela e Menaxhimit organizativ
37. Fusha 3. Kurrikula

38. Examples of study plans and programmes for the study cycles 1, 2 and 3 for each faculty, including relevant syllabi.docx (Shembuj të programeve dhe planeve të studimit për ciklet e studimit 1, 2 dhe 3 për çdo fakultet, përfshirë edhe syllabuset përkatëse)
39. Examples of study plans and programmes for the study cycles 1, 2 and 3 for each faculty, including relevant syllabi.docx (Shembuj të programeve dhe planeve të studimit për ciklet e studimit 1, 2 dhe 3 për çdo fakultet, përfshirë edhe syllabuset përkatëse)
40. Examples of study plans and programmes for the study cycles 1, 2 and 3 for each faculty, including relevant syllabi.doc (Shembuj të programeve dhe planeve të studimit për ciklet e studimit 1, 2 dhe 3 për çdo fakultet, përfshirë edhe syllabuset përkatëse)
41. Procedures for drafting and approving the study programmes for each faculty cycles 1, 2, recently approved.doc (Procedurat për përgatitjen dhe miratimin e programeve të studimit për ciklet 1 dhe 2 të miratuar për çdo fakultet)
42. Procedures for supporting and improving the quality of study programmes.docx (Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit)
43. Shembuj të raporteve të vlerësimit (Shqip)
44. Examples of periodic assessment reports of the study programmes.doc (Shembuj të raporteve periodike të vlerësimit të programeve të studimit)
45. LEARNING CREDIT POLICY. ALB.doc (Politika e Krediteve të të mësuarit)
46. Udhëzim për normat e ngarkesës mësimore (Shqip)
47. Procedures for supporting and improving the quality of teaching.doc (Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së të mësuarit)
48. AREA 4. Teaching, learning, evaluation and research FUSHA 4. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi)
49. Profile of staff training on programmes of cycle 1 and 2 in each faculty.doc profil i trajnimit të stafit në programe të ciklit 1 dhe 2 në çdo fakultet)
50. Students evaluation policies and academic regulations of programmes.docx (politikat e vlerësimit të studentëve dhe rregulloret akademike të programeve)
51. Politikat e trajtimit të ankesave (Shqip)
52. Shembuj të evidencave të komisioneve (Shqip)
53. Research priorities and policies with examples of implementation at faculty/institution level.docx (Politikat dhe prioritetet e kërkimit me shembuj të zbatimit në nivel fakulteti/institucioni)
54. The latest report of the evaluation of scientific research.docx (Raporti më i fundit i vlerësimit të kërkimit shkencor)
55. Policy or approach of staff and student mobility.docx (Politika apo qasja për mobilitetin e stafit dhe studentëve)
56. Procedures for supporting and improving the quality of teaching.doc (Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies)
57. Koncepti i arsimimit ushtarak (Shqip)
58. Pyetësor (Shqip)
59. AREA 5 Students and their support (Fusha 5. Studentët dhe mbështetje e tyre)
60. Students counselling, student's academic guide, support and mentoring.docx (Këshillimi i studentëve, orientimi akademik i studentëve, mbështetja dhe mentorimi i tyre)
61. Assistance given to the students for their career, employment and different consultation approaches.docx (Ndihma e ofruar studentëve për qasjen ndaj karrierës, punësimit dhe çështjeve të ndryshme)
62. Student's manual.docx (Manuali i studentëve)
63. Students statistics, key performance indicators.docx (Statistika studentësh, treguesit kryesorë të performancës)
64. Students membership and representation in Higher Education Institutions Organizations.docx (Anëtarësia e studentëve dhe përfaqësimi e tyre në organizatat e institucioneve të arsimit të lartë)
65. Anketimi i stafit

66. Anketimi i studentëve
67 Shembuj të procesverbaleve të mbledhjeve:
67.1 Senati Akademik
67.2 Rektori
67.3 Kuvendi Akademik (Shqip)
67.4 Këshilli i Etikës
67.5 Dekanati
67.6 Bordi i Administrimit
67.7 Bordi i Ekuivalentimit
68. Shembull i stafit akademik dhe pyetësorëve të studentëve përfshirë përgjigjet ndaj shqetësimeve
69. Kompetencat dhe atributet e Departamentit të Kurseve
70. Përmbledhje e dokumenteve në gjuhën shqipe
71. Orari i mbledhjeve 2016-17 të Bordeve, Këshillave dhe Komisioneve
72. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit
73. Raporti Vjetor i dërguar në MAS (Shqip)
74. Përshkrimi i punës për udhëheqësin e departamentit/Pedagog i lartë
75. Marrëveshje me Institucione të Jashtme - Universiteti i Tiranës
76. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Ministrisë për Forcat e Sigurisë së Kosovës
77. Lista e veprimtarive të integritit social për stafin dhe studentët
78. Procedurat për hartimin dhe miratimin e buxhetit
79. Procedurat e menaxhimit dhe auditimit
80. Pyetësi mbi infrastrukturën dhe ambientet
81. Fletëpalosje informuese
82. Kopje e planit të trajnimit të stafit për AFA
83. Shembull i vlerësimit të performancës për stafin akademik
84. Planet për përfundimin e punës me daljet e emergjencës dhe sistemet e ngrohjes (shqip)
85. Shembull i dokumenteve të vlerësimit mujor
86. Procedurat për përparimin e studentëve nga studimi i ciklit të parë në ciklin e dytë
87. Programet e diplomave dhe suplementeve të diplomave dhe profili i arritjeve
88. Shembuj të programeve të studimit duke përfshirë:
88.1 Kurrikulën dhe përmbajtjen e lëndës
88.2 Modelin e programit
88.3 Kualifikimin e personelit që realizon kurrikulën
89. Propozimi i programit të ri dhe procedurat e miratimit
90. Përshkrimi i menaxhimit të ankimeve dhe ankesave
91. Lista e sektorëve ku janë punësuar të diplomuarit në 2 vitet e fundit ose deklarimi i llojeve të vendeve të punës (Shqip)
93. Sqarimi i planifikimit dhe menaxhimi i kërkimit (shqip)
94. Kopja e Planit të Strategjisë së Kërkimit të AFA-së
95. Shembuj të kërkimeve të ndërrmarra me institucionet partnere (shqip)
96. Shembull i botimeve nga stafi mësimdhënës i AFA-së
97. Plani i Veprimtarive Kërkimore Shkencore të Departamentit
98. Një shembull i një dokumenti teorik në një revistë shkencore (Shqip)
99. Politika për pranimin e personave që i përkasin pakicave dhe regjistrimi i grupeve të marginalizuara
100. Programi i Orientimit për Studentët e Rinj (Shqip)
101. Lista e programeve të ciklit të parë për 77 studentë aktualë që studiojnë jashtë AFA-së
102. Prezantimi i Stërvitjes nga Qendra e Simulimit të FA-së

103. Lista e personelit aktual sipas departamentit
104. Statusi aktual i studentëve të Doktoraturës, programi i të cilëve është pezulluar
105. Plani i përkohshëm për përmirësimin e ndërtesës
106. Shembuj të kurrikulave të programeve nga institucionet partnere të NATO-s
107. Kurs i Studimeve të Lartë Sigurinë dhe Mbrojtjen
108. Vizitë në Muze dhe biseda për mbështetjen e mësimdhënies
109. Vizitë në Qendrën e Gjuhëve të Huaja dhe dëshmi për burimet
110. Deklaratë mbi ekuivalentimin e titujve
Mbledhje
M1 Mbledhje 1 me Koordinatorin dhe Grupin e RVV-së
M2 Mbledhje 2 me Rektorin
M3 Mbledhje 3 me Stafin e lartë drejtues
M4 Mbledhje 4 me Studentët
M5 Mbledhje 5 me Stafin akademik
M6 Mbledhje 6 me Personelin mbështetës